



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Procesverbal i mbajtur më 10 mars 2021, në mbledhjen e XLIV (dyzet e katër) të Kuvendit të Komunës së Podujevës, mandati i VI.

Mbledhja filloi në orën 10;10 dhe u mbajt në sallën e mbledhjeve në objekt të Komunës.

Mbledhjen e kryesoi z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit të Komunës.

Në mbledhje të pranishëm ishin të gjithë këshilltarët/et e Kuvendit të Komunës, përveç z.Blerim Maqastena, i arrestuar, ndaluar dhe i paraburgosur në shtetin e Serbisë, (Lista e nënshkrimeve).

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Gjithashtu në mbledhje të pranishëm ishin edhe z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, znj.Marigona Lahu, Nënkryetare e Komunës, Drejtorët e Drejtorive të Komunës së Podujevës, përfaqësues të OJQ – SDK, mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të LMT KFOR – Podujevë, si dhe një numër i qytetarëve dhe zyrtarëve komunal.

z.Fatmir Gashi, Kryesuesi i Kuvendit, e hapi mbledhjen duke i përshëndetur të pranishmit dhe duke iu dëshiruar punë të mbarë. Gjithashtu Kryesuesi kërkoj respektimin e masave anti Covid-19. Kuorumi për punë dhe vendimmarrje ekziston andaj ne mund të vazhdojmë me punë dhe vendimmarrje në këtë seancë, materialet gjithashtu i keni marrë me kohë përshirë edhe rendin e ditës dhe konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e KPF-së. Nëse ndokush dëshiron fjalën urdhëroni.

z.Pajtim Balaj, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik-DPZHE, theksoi, para se të vihet në votim rendi i ditës, kam një kërkesë që pika 4 e rendit të ditës të hiqet nga rendi i ditës me mundësinë që të kthehet sërish në njërin nga seancat e ardhshme. Arsyeja për këtë është për faktin që ne kemi përgatitur një draft të pjesshëm për ndryshimin e rregullores, përkatësisht për ndryshimin e orarit të punës së bizneseve, ndërkohë që rekomandimet KPF-së kanë qenë që kjo rregullore të rishqyrtohet në tërësi, prandaj kërkesa është që të hiqet kjo pikë e rendit të ditës me mundësinë që së shpejti të kthehet sërish si pikë në seancat e ardhshme me mundësinë për t'u shqyrtuar në tërësi kjo rregullore.

z.Fatmir Gashi, Kryesuesi i Kuvendit, theksoi rreth kësaj arsyeshmërie rekomandimet e KPF-së kanë qenë që rregullorja si e tillë tërësisht të shkoj në debat publik, e jo pjesërisht siç ka ardhë. Tani kërkesa e drejtorit parafolës të Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik është që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për seancat e radhës.

znj.Fatlume Jaha, theksoi, meqenëse se dje në KPF unë propozova që kjo rregullore të shkoj si tërësi në plotësim ndryshim dhe përveç kësaj janë rekomanduar saktë edhe datat kur do të del në debat publik. Unë nuk shohë ndonjë pakënaqësi në këtë mes për shkak se prezent ishte edhe Kryetari Komunës ku ai dhe të gjitha grupet e asamblistëve u pajtuan që plotësim ndryshimi në tërësi i kësaj rregulloreje është një domosdoshmëri e kohës prandaj unë nuk shohë ndonjë arsye të madhe që ta heqim këtë pikë të rendit të ditës. Ne nuk jemi pengesë që ta hedhim rregulloren si tërën në plotësim ndryshim. Rregullorja besoj se do të pasurohet në diskutimet dhe debatet publike ku do të marrin pjesë përfaqësuesit e punëtorëve, ata të bizneseve dhe do të plotësohet ndryshohet gjatë këtij procesi dhe në fund versionin final do ta sillni ju si Ekzekutiv që ta miratojmë në Kuvend.

z.Florent Hasani, theksoi, ne Grup i këshilltarëve nga radhët e LVV-së e mbështesim propozimin për shtyrjen e kësaj pike të rendit të ditës për një mbledhje tjetër të radhës së Kuvendit.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, ne dje në KPF kemi debatuar dhe bashkërisht edhe me drejtorin e DPZHE por dhe me Grupet e këshilltarëve të Kuvendit, madje edhe me Kryetarin e Komunës në parim jemi pajtuar që për këtë pikë të rendit të ditës të kalojë dhe t'i rekomandohet Kuvendit për këtë seancë dhe të vazhdoj për diskutim publik sipas konstatimeve që na janë sjellë ku është përcaktuar edhe kohëzgjatja e diskutimit publik dhe data e debatit me qytetarë, dhe tani pas asaj mbledhje qenka dalë ky qëndrimi tjetër i Grupit të këshilltarëve të LVV-së dhe i drejtorit të DPZHE. E gjitha çka do të shqyrtohet në këtë rregullore është orari i punës për ditën e diele dhe eliminimi i pikës 6 dhe 6.1 të nenit 2 të paraparë në draft rregulloren e re. Unë mendoj që vetëm dy pika të rregullores duhet të ndryshohen, dhe atë, që dita e diele të jetë ditë pune për shkak të kërkesave që na njoftoj drejtori. Konsideroj se orari i punës është mirë të jetë unik dhe të mos ketë diferencime ekonomike mes bizneseve që dikush të punojë deri në orën 13:00, e dikush deri në orën 23:00.

Mendoj se të gjitha këto mendime të të gjitha Grupeve të këshilltarëve të Kuvendit, pastaj nga takimet e drejtorit me bizneset që do të zhvillohen qoftë në ambiente të mbyllura apo me vizita në terren, si dhe po ashtu për faktin që për këtë pikë dje në mbledhjen e KPF-së jemi dakorduar që do t'i kalojmë të gjitha konservimet politike dhe partiake sepse kemi të bëjmë me interesin e qytetarëve dhe të bizneseve. Pra nuk nënkupton dhe nuk do të ketë barrikadim politik veç se ne nuk dëshirojmë që kjo pikë të shtyhet për një seancë të radhës, pikë për të cilën faktikisht vet drejtori i DPZHE po deklarohej kundër propozimit të vet dhe propozimit të Kryetarit të Komunës që e ka sjellë.

Kështu që ne si Grup i këshilltarëve të PDK-së jemi që të vazhdohet me këtë pikë të rendit të ditës sipas rekomandimeve tona, të mbahen diskutime dhe debate publike për çka janë caktuar edhe datat përkatëse, dhe do të kenë mundësi që të gjithë qytetarët, bizneset dhe të gjitha Grupet e këshilltarëve t'i sjellin propozimet e tyre për sa i përket rregullores, si tërësi, për orarin e punës së bizneseve.

Po e përsërisë, ne Grup i këshilltarëve të PDK-së do e mbështesim qëndrimin e mëparshëm të kësaj pike dhe nuk do të barrikadohemi rreth këtij procesi veç se jemi opozitë kur kemi parasysh që ndryshimi i kësaj rregulloreje është në interes të qytetarëve në nivel Komune. Pra jemi që të vazhdohet me miratimin e rendit të ditës sipas rekomandimeve të KPF-së, që rregullorja të del në tërësi në diskutim/debat publik përfshirë edhe kohëzgjatjen dhe datat e diskutimit publik të cilat i ka caktuar drejtori i DPZHE në mbledhjen e KPF-së, dhe të marrim një miratim në Kuvend për këtë, nëse nuk mund të kalojmë këtë pikë sot, nuk do të thotë që në të ardhmen nuk mund ta kalojmë.

z.Pajtim Balaj, drejtor i DPZHE, theksoi, çështja është që ne pas diskutimeve me zyrën ligjore e kuptuam që proceduralisht debatit publik mund t'i nënshtrohet vetëm draftit që ne e kemi përgatitur paraprakisht, nuk mund t'i nënshtrohet debatit publik në tërësi e gjithë rregullorja. Pra kjo çështje është më shumë procedurale se sa politike, unë po kërkoj nga ju që kjo pikë të shtyhet për seancat e ardhshme në mënyrë që të krijohen mundësit për plotësimin edhe të kërkesave për pjesën që ju i cekët, përkatësisht që rregullorja të shqyrtohet në tërësi dhe që në draftimet e ardhme të përfshihen edhe Grupet e këshilltarëve të Kuvendit të Komunës para se t'i nënshtrohet debatit publik.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, i nderuar drejtor, ju keni qenë dje në mbledhjen e KPF-së, dhe i keni marrë pikat e mbështetjes unanime të Grupeve të këshilltarëve të Kuvendit, ne jemi në opozitë dhe tani po i bie që unë po flas vetëm politikisht, por më vie keq sepse ti s'ke punuar asgjë në dokument prej përfundimit të mbledhjes së KPF-së, nuk i ke nxjerrë pikat për të cilat të gjithë jemi pajtuar dhe kemi qenë unanim mes rekuizicionit që të punohet të dielave, që të vazhdohet orari i punës dhe që të mos shkohet me kërkesa përmes DPZHE për disa bizneset të lejohen të punojnë, pra kemi menduar të gjithë duke përfshirë edhe grupin e këshilltarëve të LVV-së që mos të jetë ajo pikë që drejtori t'ju japë leje pune bizneseve, andaj e ceka se nuk e ke sjellë draft rregullore ekzistuese për ta miratuar

dhe ta kaluar në dëgjim publik. Ju sigurisht e keni mbajtur një takim me Grupin e këshilltarëve të LVV-së dhe keni propozuar që pika e 4 e rendit të ditës të shtyhet për mbledhjen e radhës, e që nënkupton se ju si drejtor nuk e keni kryer detyrën tuaj, mirëpo nëse keni punuar diçka në dokument nga dita e djeshme atëherë jemi në rregull dhe e kuptoj se proceduralisht në diskutim publik mund të kaloj një dokument kur votohet në Kuvend. Sipas mendimit tim ju e keni kryer vetëm një detyrë, ke mbajtur një takim me këshilltarët e LVV-së dhe në atë takim keni propozuar që të shtyhet kjo pikë e rendit të ditës dhe nuk keni punuar asgjë pas miratimit që e morëm bashkërisht në KPF, kështu që ju nuk e keni kryer detyrën e juaj, nëse keni kryer ndonjë detyrë atëherë thuaje, shembull, e kam kryer por për këtë ndryshim nuk më ka mbështetur grupi im. Nëse nuk ju ka mbështetur Grupi juaj drejtor, atëherë ne si Grup i këshilltarëve të PDK-së ju mbështesim sepse ne nuk jemi kundër juve si drejtor i DPZHE por jemi këtu për t'ju lehtësuar punën, madje unë edhe në KPF u deklarova se edhe pse jemi opozitë mund ta bëjmë një propozim sikur të isha unë drejtor.

Absolutisht si asamble kemi marrë qëndrim të gjithë që për këtë pikë të rendit të ditës nuk do të ketë barrikadim politik për shkak të situatës së krijuar nga pandemia covid-19 dhe situatës së krijuar ekonomike të bizneseve, andaj absolut vota ime është pro. Ju nuk keni punuar asgjë drejtor sepse nuk e keni sjell asnjë dokument, ndërsa Grupi i këshilltarëve të LVV-së dhe në prezencë të Kryetarit të Komunës ka marrë qëndrim të tillë, kurse ti vetëm e ke mbajtur një takim dhe po propozon që të shtyhet kjo pikë e rendit të ditës.

z.Fatmir Gashi, Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, te propozimet për rend të ditës nuk ka diskutime të gjata, andaj t'i përmbahemi Rregullores, bëhen propozimet, hedhën në votim, kalon ose nuk kalon, andaj të mos kalojmë në debate sepse nuk parashihet kjo me rregullore.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, unë mendoj se propozuesi i një pike të rendi të ditës në çdo fazë dhe në çdo kohë ka të drejtë ta tërheq atë pikë që e ka propozuar prandaj pas diskutimeve të cilat janë bërë brenda Ekzekutivit është vlerësuar se duhet të tërhiqet kjo pikë nga rendi i ditës për të cilën drejtori i DPZHE e ka paraqitur edhe problemin se pse kërkohet tërheqja e kësaj pike të rendit të ditës, prandaj unë nuk e shohë të rëndësishme ndonjë arsye tani që të diskutohet rreth kësaj pike sepse propozuesi ka të drejtë ta tërheq nga rendi i ditës në çdo fazë.

Pra drejtori i DPZHK propozoj dhe po kërkon të tërhiqet kjo pikë, prandaj nuk po e shohë ndonjë arsye që kjo çështje të shtyhet tutje.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, zotëri Kryetar, është shumë e vërtetë ajo që cekët ju sepse aq sa ka të drejtë drejtori i Drejtorisë përkatëse ta heqë këtë pikë të rendit të ditës, aq të drejtë, madje edhe më shumë të drejtë ligjore dhe fuqi ligjore ka Kuvendi i Komunës që ta shfuqizoj rregulloren ekzistuese apo vetëm ato dy nene që janë të miratuara në kuadër të rregullores në këtë Kuvend. Pra Kuvendi i Komunës me shumicë të votave sot mund të merr vendim që të shfuqizohet rregullorja ekzistuese e cila rregullon orarin e punës së bizneseve, dhe njëkohësisht të kërkoj që plotësim ndryshimin e pikave të cilat sanksionojnë punën e bizneseve ditëve të diela dhe që kufizojnë orarin e punës, nëse ka disponim Kuvendi mund ta votoj. Është mirë që kjo pikë e rendit të ditës të kaloj ashtu siç kemi rekomanduar dhe përmes Grupeve të këshilltarëve të Kuvendit nga të gjitha subjektet politike të propozohen ndryshimet e atyre pikave, pastaj është e drejtë morale që të mos deklarohen apo mos deklarohen asamblistët sepse përfaqësojnë dikë, ndërsa nuk lëvizin asnjë propozim, madje këtu ka raste kur diçka tjetër flitet e diçka tjetër veprohet.

Kërkoj nga Grupet e këshilltarëve të subjekteve politike një qëndrim të tyre rreth kësaj pike se a dëshirojnë të vazhdojnë orari i punës sipas rregulloreje apo dëshirojnë ta ndryshojnë atë orar.

znj.Fatlume Jaha, theksoi, dëshiroj të bëjë një sqarim për hir të korrektësisë, për qytetarët dhe për të gjithë kolegët që nuk kanë qenë në mbledhjen e KPF-së, z.Rafet Llapashtica shumë kjashtë e ka pyetur drejtorin e DPZHE rreth aspektit ligjor dhe procedural të kësaj propozimi rregulloreje dhe ne

kemi marrë një garanci prej drejtorit në fjalë se gjithçka është në rregull. Sot më duket shumë e çuditshme që me arsyeshmërinë që e ceku drejtori ka ardh në mbledhje dhe deklaroheni se duhet ta tërhiqni këtë propozim rregullore.

z.Ragip Fetahu, theksoi, qëllimi ynë është lehtësimi i jetës së qytetarëve dhe faktikisht atë që e ceku z.Rafet Llapashtica është e drejtë, mirëpo është mirë që zotëri Llapashtica së bashku me ne, pasi që kemi qëllim lehtësimin e jetës së qytetarëve, të ulemi së bashku jashtë kësaj seance dhe t'i bëjmë të gjitha ndryshimet e nevojshme në rregullore, duke marrë për bazë të gjitha propozimet e të gjitha Grupet të këshilltarëve të Kuvendit, dhe të vazhdojmë tutje.

z.Pajtim Balaj, drejtor i DPZHK, theksoi, një sqarim për këshilltarin z.Rafet Llapashtica, ne nuk po kërkojmë nga ju që ta tërheqim këtë propozim ose ta lëmë të njëjtën, ne po kërkojmë që këtë propozim rregullore ta shtyjme për një afat në mënyrë që të jemi më të përgatitur në mënyrë që proceduralisht mos të kemi probleme që drafti ynë të mos ketë mundësi të vëhet në diskutim publik. Ne në mbledhjen e KPF-së kemi diskutuar rreth bazës ligjore të përmbajtjes së draftimit të propozim rregullores së re, por jo për çështje procedurale se si vihet në diskutim publik.

Proceduralisht drafti të cilin ne e kemi përgatitur i nënshtrohet debatit publik, jo rregullorja në tërësi ashtu siç e ka kërkuar znj.Fatlume Jaha dhe në mbledhjen e KPF-së.

z.Hasan Ajeti, theksoi, ne jemi duke e diskutuar një propozim rregullore, realisht unë kam gjykuar se këta janë dakorduar në mbledhjen e KPF-së, ku nga ana e drejtorit të DPZHE është sjellë i pjesshëm, propozimi i anëtarëve të KPF-së ka qenë që kjo propozim rregullore të kalojë si pako/tërësi, e që e mbështes edhe unë për vet faktin se kemi të bëjmë me operator të ndryshëm ekonomik dhe për faktin se qëllimi i Ekzekutivit dhe i Kuvendit të Komunës është lehtësimi i punës së bizneseve dhe qytetarëve. Tani realisht jemi në një situatë tjetër, Ju zotëri Balaj po kërkon që të tërhiqet kjo pikë e rendit të ditës ndërsa anëtarët e KPF-së po deklarohen se Ju keni qenë prezent në mbledhjen e KPF-së dhe jeni dakorduar që ky propozim të jetë si rekomandim ose si propozim, mirëpo tani gjykoj se në aspektin procedural më herët është dashur të konsultoheni me zyrtarët ligjor të Komunës në mënyrë që të mos vije situata në këto pengesa apo barrikadime, dhe pastaj të jepen epitete apo cilësime politike. Nuk e konsideroj se për këtë çështje duhet të ketë elemente politike sepse jemi të pavarur në deklarime dhe secili mund të votojmë sipas bindjeve të veta, mirëpo unë nuk e shohë këtë çështje si konstatim të KPF-së që plotësim ndryshimi i rregullores në fjalë të shkojë si pako/tërësi sepse ashtu është konstatuar dhe rekomanduar nga KPF. Ju zotëri Balaj po kërkon ta tërhiqni këtë propozim dhe në qoftë se e kërkon votën atëherë Kryesuesi i Kuvendit ta vë në votim dhe të vazhdojmë tutje.

z.Fatmir Gashi, Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, sa për vëmendjen e juaj, kërkoj nga të gjithë këshilltarët e Kuvendit të Komunës që nga seanca e radhës të gjithë të pajiseni me kartela dhe të votojmë përmes sistemit elektronik.

z.Haki Rudari, theksoi, unë kam qenë pjesë e KPF-së për 4 vite dhe mund të them se KPF mund të japë vetëm rekomandime e assesi të marrë vendime. Përfaqësuesit e partive politike kanë qenë në takimin e KPF-së mirëpo ajo që dua të nxjerrë rreth kësaj rregulloreje është një lloj konsensusi.

Unë po e shohë dëshirën e gjithë këshilltarëve të asamblesë komunale që të përgatitet një rregullore sa më e mirë e cila është në dobi të qytetarëve dhe të bizneseve të Komunës së Podujevës.

E falënderoj drejtorin dhe Drejtorinë përkatëse për të gjithë këtë angazhim që ka bërë për këtë propozim rregullore mirëpo në të njëjtën kohë unë kam konstatuar se plotësim ndryshimi i kësaj rregulloreje është interes i të gjithëve që me një konsensus, pa dashur që të përfitoj politikisht asnjë subjekt politik për arsye se rregullorja aktuale është nxjerrë në kohën kur LDK ka qenë në pushtet, andaj propozoj që të gjitha Grupet e këshilltarëve të subjekteve politike të organizohemi dhe të dakordohemi që kjo propozim rregullore të shtyhet për një seancë tjetër të radhës.

Duke u bazuar në propozimin e këshilltares znj.Fatlume Jaha të dhënë në KPF, është mirë që të gjitha Grupet e këshilltarëve pa dashur të ketë politizim nga askush se kush po fiton apo kush po humb, mendoj se është interes i të gjithëve që të dakordohemi rreth kësaj pike që në seancën e radhës të futet si propozim rregullore n'kuadër të rendit të ditës. Sigurisht drejtori i DPZHE e merr përgjegjësinë për angazhimet dhe ndryshimet në rregullore, andaj është interes i të gjitha Grupeve të këshilltarëve që në mënyrë unanime me anë të një konsensusi ta shtyjme këtë pikë të rendit të ditës për seancën e ardhshme në mënyrë që Drejtoria përkatëse ta përgatit draft rregulloren më mirë, por edhe ne si këshilltarë të Kuvendit të kemi informata më të sakta rreth kësaj çështje.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, ne anëtarët e KPF-së e dimë procedurën e mbledhjeve KPF-së, mirëpo insistimi ka qenë që kjo pikë e rendit të ditës të sjellët në Kuvend. Propozimin të cilin e dha z.Haki Rudari për të gjitha Grupet e këshilltarëve, jam i sigurt që drejtori i DPZHE nuk i ka ftuar të gjithë anëtarët e LVV-së për t'i pyetur për këtë rregullore, e që tani del dhe i fton të gjitha Grupet e këshilltarëve. Unë absolutisht se kam problem që dikush të jetë pjesë e grupit punues për këtë rregullore. Ne në mbledhjen e mbajtur në KPF kemi dashtë që kjo pikë të ndalet në KPF dhe të mos sjellët deri këtu ku është sjellë, si procedurë është fjala, por insistimi i drejtorit të DPZHE dhe i Grupit të këshilltarëve nga radhët e LVV-së ka qenë që kjo pikë e rendit të ditës të sjellët në Kuvend. Drejtori i DPZHE i ka marrë rekomandimet dhe është zotuar, madje edhe me propozimin dhe mendimin e Kryetarit të cilin e kemi mbështetur edhe ne, të merren për bazë ato rekomandime dhe të përgatitet dokumenti për Kuvend, mirëpo drejtori i DPZHE nuk e ka ndërmarrë asnjë veprim për plotësim ndryshim e dokumentit, por vetëm ka ardhë sot në seancë me të njëjtin propozim.

Unë propozoj që drejtori i DPZHE t'i rregullojë 4 rekomandimet që janë marrë në mbledhjen e KPF-së, dhe ta sjellë dokumentin në Kuvend që ta miratojmë dhe për të njëjtin pastaj të mbahen diskutime publike dhe debate publike sipas datave që janë caktuar nga vet drejtori në fjalë.

Ne nuk kemi arsye të mbledhemi si Grup sepse këtu vetëm dy pika kanë për t'u ndryshuar, ato janë leja për punë gjatë ditëve të diela dhe orari për punë pas orës 13:00 po ashtu të dielave, pra fjala është për dokumentin e propozim rregullores për të cilën drejtori i DPZHE nuk ka punuar në këtë aspekt. Këto dy pika kanë për t'u diskutuar edhe gjatë kohës sa rregullorja do të qëndroj në diskutim publik, nëse miratohet sot. Se a e ka lexuar drejtori apo jo rregulloren, është çështje personale dhe nuk dua të ndërhyjë në punët zyrtare, por unë dua ta kryej detyrën time si anëtar i KPF-së dhe i Kuvendit të Komunës.

Për fund kam pyetje për drejtorin e DPZHE, përse drejtor nuk i ke futur rekomandimet e KPF-së në propozim rregullore dhe pastaj të njëjtën ta sjellje në Kuvend, po që se do të bënit një gjë të tillë, atëherë ke pasë mundësi me dalë para Kuvendit dhe me paraqitur propozim ndryshimet përkatëse, e jo tani të "nxirresh cipra".

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, po më duket se ende jemi në rend të ditës dhe nuk është në rregull disa herë me i përsëritur të njëjtat gjëra z.Rafet Llapashtica, në qoftë se ju po insistoni me futë këtë pikë në rend të ditës urdhëro bëjeni, të jetë iniciativë e juaja kjo dhe të vazhdojmë tutje. Nuk keni nevojë të na impononi gjëra, ne e kemi filluar këtë iniciativë, ne po e tërheqim këtë iniciativë, mirëpo po deshe ti zotëri Llapashtica që ta fusësh këtë pikë të rendit të ditës urdhëro propozojë këtë pikë të rendit të ditës dhe të hedhet në votim.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, zotëri Kryetar, ne rend dite në Kuvend nuk sjellim por ju e sjellni rendin e ditës në Kuvend, kjo pikë e rendit të ditës ka ardhë prej Ekzekutivit dhe jo nga ana jonë, ne jemi që kjo pikë të futet në rend të ditës, përkatësisht miratimi i vendimit për vënie në diskutim publik të rregullores, si tërësi, për orarin e punës së bizneseve në mënyrë që të sjellën propozimet për këtë çështje, të mbahen takimet publike me përfaqësuesit e bizneseve dhe të miratohet pastaj ashtu

siç vendos shumica në Kuvend. Pra ky është qëndrimi i Grupit të PDK-së, të kalojë propozim vendimi që është sjellë nga vet organi ekzekutiv duke përfshirë edhe rekomandimet e KPF-së.

z.Fatmir Gashi, Kryesuesi i Kuvendit, jemi ende në rend të ditës dhe konsideroj se debati për këtë pikë përfundoj meqë nuk ka të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën, unë e hedh në votim propozimin e drejtorit të Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik për tërheqje nga rendi i ditës i kësaj mbledhje propozim rregulloren për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores për orarin e bizneseve që operojnë në territorin e Komunës së Podujevës, përkatësisht vënien e të njëjtës në diskutim publik.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se meqë 11 vota janë për, 21 vota kundër dhe 1 votë e përmbajtur, nuk miratohet propozimi për tërheqje nga rendi i ditës në këtë mbledhje, propozim rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për orarin e punës së bizneseve që operojnë në territorin e Komunës së Podujevës.

Kryesuesi i Kuvendit, në vazhdim theksoi, tani e vë në votim rendin e ditës materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhjeje duke përfshirë edhe konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me 21 vota, asnjë votë kundër dhe 12 vota të përmbajtura, u miratua rendi i ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës të kësaj mbledhje duke përfshirë edhe konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur një ditë më parë.

1. Procesverbalet nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës, të mbajtura më:

30 dhjetor 2020; 06 janar 2021; 03 shkurt 2021; 17 shkurt 2021

Njëzëri, pa vërejtje apo plotësim ndryshime, u miratuan në pako procesverbalet nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës sipas kësaj pike të rendit të ditës

2. Propozim Rregullore për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një (1) vit të pronës së paluajtshme të Komunës

➤ ***Propozim vendimi për vënie në diskutim publik***

znj.Bahrie Shatrolli-Mehmeti, drejtoreshë e Drejtorisë së pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë - DPKGJ, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, ndër të tjera theksoi, këtu para Juve si Kuvend po e prezantoj projekt Rregulloren për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një (1) vit të pronës së paluajtshme të Komunës, dokument i cili fillimisht është sjellë për diskutim eventual në këtë mbledhje dhe që i njëjti apo me plotësim ndryshime eventuale të del në diskutim publik ku pastaj sipas procedurave përkatëse dhe rekomandimeve të arsyeshme nga diskutime dhe debati publik të diskutimit publik të sjellët sërish në rend të ditës për shqyrtim final nga ana e Juaj të nderuar këshilltarë të Kuvendit. Kjo propozim rregullore është hartuar fillimisht nga Asociacioni i Komunave të Kosovës si model për komunat e Kosovës e cila pastaj është shqyrtuar sërish nga një grup punues i administratës komunale.

Mbështetur në Ligjin për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, nenin 6 paragrafi 1.3, të Ligjit nr.06/L-092 për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, neni 7 paragrafët 1 dhe 2 të Rregullores (QRK) nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, ky dokument përbëhet nga 19 nene të cilat janë në pajtim të plotë me legjislacionin në fuqi dhe se vlera e dhënies së pronës komunale në shfrytëzim për më pak se një vit do të jetë në harmoni me Rregulloren për taksa tarifa dhe gjoba komunale e miratuar në vitin 2018 nga Kuvendi i Komunës së Podujevës.

z.Florent Hasani, theksoi, ashtu siç e dha arsyetimin drejtoresha e DPKGJ për nevojën e miratimit të kësaj rregulloreje, ne Grupi i këshilltarëve të LVV-së e mbështet propozim për vënie në diskutim publik Rregullore për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një (1) vit të pronës së paluajtshme të Komunës. Sugjerojmë që të respektohen procedurat ligjore dhe të përzgjedhurit të jenë vetëm ata të cilët i plotësojnë kushtet për aplikim, po ashtu edhe kriteret, kushtet dhe parimet e parapara me rregullore në mënyrë që funksionimi të jetë sa më efikas.

z.Hasan Ajeti, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve të LDK-së, në parim e mbështesim këtë propozim Rregullore për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një (1) vit të pronës së paluajtshme të Komunës, përkatësisht vënien e të njëjtës në diskutim publik. Arsyetimin e këtij propozimi e bëri drejtoresha e DPKGJ, në aspektin procedural kjo rregullore është në harmoni me ligjin andaj gjatë diskutimit publik kjo rregullore do e merr formën e saj kështu që ne në parim e përkrahim.

z.Fatmir Rudari, theksoi, edhe ne Grupi i këshilltarëve të PDK-së e përkrahë këtë propozim rregullore që të kaloj në diskutim publik.

znj.Mrika Thaçi, theksoi, propozim rregulloren për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një (1) vit të pronës së paluajtshme të Komunës, e mbështes duke menduar që do të kontribuoj në proceset ligjore për dhënien në shfrytëzim pasurinë komunale.

Me këtë rregullore besoj shumë se do të krijohen kushte të barabarta për operatorët konkurrentët për marrjen në shfrytëzim të kësaj prone në kohëzgjatje më pak se një vit. Duke u bazuar nga fakti që kjo rregullore do të dal në diskutim publik dhe do të pasurohet me ndonjë specifik nga grupet e interesit dhe nga të gjithë qytetarët për dhënie të kontributit të tyre në këtë rregullore ne do ta japim mbështetjen.

z.Fatmir Gashi, Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar për të marrë fjalën rreth kësaj pike urdhëroni, nëse jo, e hedhë në votim propozim vendimin për vënie në diskutim publik të propozim rregullores për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një (1) vit të pronës së paluajtshme të Komunës, përkatësisht propozim vendimit për vënie në diskutim publik sipas materialit përkatës dhe konstatimeve të rekomanduara nga Komitetit për politikë dhe Financa.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri u miratua Propozim vendimi për vënien në diskutim publik të propozim Rregullores për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një (1) vit të pronës së paluajtshme të Komunës sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje dhe konstatimeve të rekomanduara nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa.

3. Propozim Rregullore për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijës

➤ Propozim vendimi për vënie në diskutim publik

z.Driton Veliu, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale – DSHMS e paraqiti fjalën hyrëse për këtë pikë të rendit të ditës, ndër të tjera theksoi, para Jush kemi paraqitur këtë propozim rregullore të re e cila është hartuar nga OJQ “ATRC” në bashkëpunim me organet përkatëse të nivelit qendror si model për të gjitha Komunat e Republikës së Kosovës në mënyrë që të miratohet nga Kuvendet e Komunave pas vendosjes së specifikave përkatëse. Ky dokument ka një volum bukur të madh të përmbajtjes, mirëpo në pika të shkurtra do t’i sqarojmë disa prej më të rëndësishmeve si dispozita të përgjithshme siç janë qëllimi, fushëveprimin dhe mekanizmat e kësaj projekt rregulloreje. Qëllimi i kësaj projekt rregulloreje është që të përcaktojë rregullat dhe procedurat për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijës në zbatimin e ligjit për mbrojtjen e fëmijës dhe kompetencat vetanake të Komunës së Podujevës ku përfshihet mbrojtja e fëmijës nga të gjitha format e dhunës fizike mendore, abuzimit, keqpërdorimit, shfrytëzimit, neglizhimit që vë në rrezik, jetën, sigurinë, shëndetin, edukimin, arsimimin dhe zhvillimin e fëmijës. Gjithashtu kjo propozim rregullore ka për qëllim përcaktimin e detyrave dhe përgjegjësi të subjekteve për mbrojtjen e fëmijës si dhe mënyrës së koordinimit, raportimit dhe bashkëpunimit me qëllim të kontributit në sistemin për mbrojtjen e fëmijës. Rëndësia e kësaj është se parashihet kontributin e një Komune Mike për Fëmijët.

Fushëveprimi i kësaj propozim rregulloreje është të zbatohen ligjet dhe rregulloret për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijës në të gjitha fazat, për të gjitha masat për veprimet dhe mosveprimet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijës nga të gjitha subjektet për mbrojtjen e fëmijës në Komunën e Podujevës, në përputhje me obligimet e dala nga ligji për mbrojtjen e fëmijës, rregullore e cila do të zbatohet për fëmijët me shtetësi Kosovare por edhe për ata fëmijë pa shtetësi, të pa regjistruar, për azil kërkuesit, refugjatët ose ata me shtetësi të huaj brenda territorit të Komunës së Podujevës. Dispozita e kësaj rregulloreje nuk mund të merret si kufizim apo pakësim i të drejtave ekzistuese të fëmijës të përcaktuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, por me këtë propozim rregullore të re ne kemi avancim të drejtave të fëmijës. Në këtë dokument janë specifikuar mekanizmat Komunal për mbrojtje të fëmijës siç janë; Kryetari i Komunës, Drejtoritë dhe njësitë përkatëse për mbrojtjen e fëmijës, Qendra për Punë Sociale QPS, ekipet për mbrojtjen e fëmijës, njësia për mbrojtjen e fëmijës, institucione shëndetësore, institucionet arsimore publike dhe jopublike për mbrojtjen e fëmijës, organizata e shoqërisë civile, familjet strehuese për e fëmijët pa përkujdesje prindërore, shtëpitë për mbrojtjen e fëmijës dhe subjektet tjera që kanë përgjegjësi për mbrojtjen e fëmijës sipas legjislacionit në fuqi.

Kohëzgjatja e diskutimit publik kam menduar të jetë prej 15 marsit 2021 deri më datë 15 prill 2021, ndërsa debatit publik të mbahet më datë 23 mars 2021, duke filluar nga ora 10: 00, në ndërtesën e re të Komunës salla e mbledhjeve.

z.Hasan Ajeti, theksoi, ne në emër të Grupit të këshilltarëve nga radhët e LDK-së e mbështesim këtë propozim rregullore e cila vjen si produkt i Ligjit për mbrojtjen e fëmijëve ku të drejtat dhe obligimet janë të përcaktuara në këtë rregullore dhe të cilat burojnë prej ligjit dhe si të tillë ne e mbështesim.

z.Ragip Fetahu, theksoi, në raportin komunal social të Komunës së Podujevës 2019-2021, ndër të tjera thuhet se Komuna e Podujevës ka 26808 fëmijë deri në moshën 14 vjeçare apo 33% e popullsisë. Kjo kategori shoqërore dhe kërkesa duke përfshirë këtu edhe mirëqenien, edukimin, mbrojtjen si dhe aktivitetet kulturore dhe sportive të cilat janë të garantuara me ligj edhe pse kemi Ligjin për mbrojtjen e fëmijës, Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijës si dhe Ligjin për

shërbime sociale dhe familjare, është nevojë lokale që Komuna jonë të ketë rregulloren që mbron dhe afirmon të drejtat e fëmijëve. Rregullorja e propozuar nga Ekzekutivi rithekson rolin e familjes në mbrojtjen dhe përkujdesjen ndaj fëmijës por nga ana tjetër obligon organet përgjegjëse lokale për ndihmë institucionale në pajisjen e prindërve me njohuri adekuate jo të dhunshme për rritjen dhe edukimin e fëmijëve, po ashtu precizon kategoritë e rrezikuara të fëmijëve që duhet të ndihmohen siç janë: fëmijët në gjendje jo të mirë në familjet e tyre, pa përkujdesje prindërore, fëmijët e abuzuar, ata që thyejnë ligjin si dhe fëmijët e komuniteteve. Rregullorja gjithashtu mundëson diversitetin apo shumëllojshmërinë kulturore, obligon Komunën e Podujevës që të ofrojë siguri për fëmijët, shërbime më të mira për ta, mundësinë e shprehjes së lirë të mendimit si dhe garantimin e pjesëmarrjes së fëmijëve në aktivitetet kulturore dhe sportive. Efekti i këtij dokumenti në radhë të parë është institucional sepse mundëson organizimin e mekanizmave lokal me qëllim që fëmijët tanë të mbrohen dhe të edukohen sa më mirë, Komuna e Podujevës me këtë merr përgjegjësi shtesë të cilat kanë edhe obligime buxhetore ku duhet të themelohet njëسيا apo të caktohet një zyrtar për zbatimin e politikave mbrojtëse ndaj fëmijëve, është obligim të caktohet buxhet shtesë për këtë qëllim, caktimi i një ekipi për realizimin e të drejtave të fëmijëve si dhe krijimin e asamblesë komunale të fëmijëve. Është e rëndësishme të theksohet se DSHMS, është e obliguar t'i gjejë tri familje me qëllim mbrojtjen dhe strehimin e fëmijëve pa përkujdesje prindërore. Rekomandimi im është që QPS duhet të ketë rol më aktiv në këtë proces në mënyrë që të kombinohen normat juridike me format sociale. Për fund kërkoj nga ju që të përkrahet kjo propozim rregullorë sepse fëmijët tanë më së miri mbrohen duke u siguruar atyre një mësues të mirë dhe me integritet, një çerdhe të mirë, kushte higjienike dhe të punës në shkollë, teatër dhe aktivitete kulturore për të ndërtuar mendim kritik si dhe garat e dijes dhe sportive me qëllim ndërtimin e shpirtit konkurrues.

z.Bashkim Sylja, theksoi, ne Grup i këshilltarëve nga radhët e PDK-së e mbështesim këtë propozim rregullorë që të kalojë në diskutim publik edhe pse ne mendojmë se kjo rregullorë është vonuar shumë sepse disa komuna e kanë miratuar shumë më parë një këtë rregullorë, mirëpo më mirë vonë se kurrë.

znj.Mrika Thaçi, theksoi, unë si nënë dhe si gjyshe sinqerisht më bënë të ndihem mirë dhe më krijohet një ndjenë shumë e mirë kur ne si shoqëri jemi rritur dhe kemi avancuar të paktën nga ana formale juridike që jemi në hap me zhvillimet shoqërore ku primare kanë përkujdesjen ndaj fëmijës, celulën e parë të një familje të shëndetshme, andaj e mbështes këtë rregullorë dhe besoj se do ta japë kontributin tim në pasurimin e saj gjatë fazës së dytë të diskutimit publik.

Unë po e përfundojë fjalimin tim me një thënie, *përderisa ne përpiqemi për t'ju mësuar fëmijëve dhe për t'ju treguar gjithçka për jetën, fëmijët tanë na mësojnë se çfarë është jeta.*

z.Fatmir Gashi, Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush të interesuar për të marrë fjalën, nëse jo atëherë e hedhë në votim propozim vendimin për vënie në diskutim publik të propozim rregullores në fjalë sipas materialit të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhjeje dhe konstatimeve të rekomanduara nga mbledhja e KPF-së.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri miratohet propozim vendimi për vënie në diskutim publik të propozim vendimit për vënie në diskutim publik të propozim rregullores për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijës sipas materialit përkatës dhe konstatimeve të rekomanduara nga Komitetit për Politikë dhe Financa.

4. Propozim Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për orarin e punës për bizneset që operojnë në territorin e komunës së Podujevës

➤ Propozim vendimi për vënie në diskutim publik

z.Pajtim Balaj, drejtor i DPZHE, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike, ndër të tjera theksoi, propozimi për plotësim ndryshim të rregullores për orarin e punës për bizneset që operojnë në territorin e Komunës së Podujevës, kërkesa është që të merret pëlqimi për debat publik e jo që të votohet rregullorja si e tillë. Debatu publik është paraparë të mbahet nga data 22 mars 2021, në orën 10:00, në ndërtesën e re të Komunës salla e mbledhjeve, kurse kjo rregullore qëndron në diskutim publik prej 15 marsit 2021 deri më datë 15 prill 2021. Propozimi ynë përfshinë disa pika të cilat janë sjellë si burim i tri lloje kërkesash në DPZHE nga qytetarët, përfaqësuesit e bizneseve dhe nga punëtorët, dhe rrjedhimisht propozimi ynë ka qenë një përpjekje që t’ju përgjigjet këtyre tri nevojave. Dokumenti që unë e prezantoj para jush është vetëm një draft, përfundimet e tij i nënshtrohen një procesi të ndryshimit pas propozimeve që vijnë nga debati publik, diskutimeve dhe propozimeve tjera që mund të vijnë.

Propozim rregullorja në fjalë nuk përfshin rekomandimet e dhëna në KPF, rrjedhimisht është drafti i përgatitur nga DPZHE dhe ashtu siç parashihet i është proceduar Kuvendit përmes Kryesuesit të Kuvendit. Në bazë të nenit 58 shkronja h) të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-014, nenit 13 paragrafi 1.1 të rregullores MAPL nr.01/2017 për procedurën për hartimin dhe publikimin e akteve të Komunës, neni 40 të Ligjit për tregtinë e brendshme nr.2004/18 dhe neni 61 paragrafi 1.8 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18, Kuvendit të Komunës së Podujevës i propozohet Rregullore për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores për orarin e punës për bizneset që operojnë në territorin e Komunës së Podujevës nr.01-311/05-007450-20.

Qëllimi i kësaj rregulloreje, neni 1 me këtë rregullore ndryshohet dhe plotësohet rregullorja për orarin e punës për bizneset që operojnë në territorin e Komunës së Podujevës nr.01-311/05-007450-20 e datës 31 janar 2020; neni 2 i kësaj rregulloreje përfshin nenin 6 të rregullores së vjetër, neni 6 fshihet dhe riformulohet si vijon, paragrafi 1. orari i punës për qendrat tregtare dhe super marketet do të jetë periudha verore prej orës 07:00-23:00, periudha dimërore 07:00-22:00, orari i punës së marketeve dhe dyqaneve të vogla do të jetë periudha verore prej orës 07:00-23:00, periudha dimërore 07:00-22:00, orari i punës për dyqane tekstili, dyqanet e këpucëve, dyqanet e pajisjeve teknike shtëpiake, të teknikës së bardhë, bizhuterive dhe veprimtarive tjera jo ushqimore me pakicë do të jetë periudha verore prej orës 07:00-22:00, periudha dimërore 07:00-22:00, orari i punës për dyqanet për pajisje të rrymës ujit dhe të ngjashme do të jetë periudha verore prej orës 07:00-23:00, periudha dimërore 07:00-22:00, orari i punës për barnatoret bujqësore, dyqanet e pemëve dhe perimeve do të jetë periudha verore prej orës 07:00-23:00, periudha dimërore 07:00-22:00. Bizneset e përfshira në këtë nen nuk punojnë ditën e diel dhe ditën e festave zyrtare, përjashtim bëjnë bizneset nga paragrafët 2, 4 dhe 5 që mund të punojnë ditën e diel prej orës 08:00 deri në orën 13:00. Bizneset nga paragrafi 2 mund të parashitrojnë kërkesë për punë në ditën e diele edhe pas orës 13:00, dhe Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik bazuar në arsyeshmërinë e kërkesës mund të lëshoj pëlqim me shkrim për lejimin e punës shtesë, pëlqim i cili lëshohet pa pagesë.

Në rast se nata e vitit të ri ose nata e Bajramit bie ditën e diel ose në ditën e festave zyrtare bizneset nga paragrafët 1, 2, 3, 4 dhe 5, të këtij neni mund të punojnë sipas orarit të rregullt të përcaktuar për periudhën kohore. Neni 3 i propozimit, neni 15 i fshihet paragrafi 2.4 dhe shtohen paragrafët 3 dhe 4 me formulimin si vijon: për ordinancat e veterinarisë orari i punës do të jetë do të jetë periudha verore prej orës 07:00-24:00, periudha dimërore 08:00-22:00, në raste të nevojave emergjente lejohet puna më gjatë se paragrafi 3.1 dhe 3.2. Të dielave dhe festave zyrtare 1 janar, 17 shkurt, dita e Fitër

Bajramit dhe dita e Kurban Bajramit është ditë pushimi, përjashtim bëjnë bizneset nga paragrafi 1 që bëjnë kujdestari si dhe bizneset nga paragrafi 3 që mund të punojnë sipas nevojave për arsye të punës specifike. Te neni 4 i propozimit ndryshohet radhitja e neneve, si në vijim, neni 20 renditet si neni 21, neni 21 renditet si neni 22, neni 22 renditet si neni 23, neni 23 renditet si neni 24, neni 24 renditet si neni 25, kurse neni 20 formulohet si vijon: Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik mundet me vendim të posaçëm kur e kërkon interesi publik të lejojë punën e bizneseve edhe në ditë pushimi apo feste. Neni 5, pas miratimit nga Kuvendi i Komunës rregullorja hynë në fuqi pas publikimit në ueb faqen e Komunës.

Pra këto janë propozimet në draftin që ne e kemi përgatitur por nuk janë finale dhe mund t'ju nënshtrihen ndryshimeve në bazë të propozimeve të arsyeshme që mund të vijnë.

znj.Fatlume Jaha, theksoi, rregullorja për orarin e punës për bizneset që operojnë në territorin e komunës së Podujevës para këtij propozim ndryshimi të kësaj rregulloreje është paraparë për rregullimin e orarit për të gjitha bizneset që operojnë në territorin e Komunës së Podujevës dhe me një unanimitet është votuar si e tillë por pas shfaqjes së pandemisë kanë ndodhur edhe gjëra të tjera. Në mbledhjen e KPF-së të mbajtur dje të gjitha grupet e këshilltarëve të Kuvendit Komunal jemi pajtuar por mendoj që edhe sot duhet të pajtohemi rreth këtij plotësim ndryshimi sepse është domosdoshmëri që kjo rregullore të plotësohet dhe ndryshohet për ta bërë më të mirën për qytetarët tanë dhe për t'i mbrojtur të drejtat e punëtorëve dhe njëkohësisht për t'ua lehtësuar aktivitetet bizneseve që operojnë në Komunën e Podujevës. Ne pas mbledhjes së KPF-së mi kemi pranuar rekomandimet përmes email adresës dhe në ato rekomandime përveç draftit fillestar të cilin e ka sjellë ekzekutivi si pikë e dytë është edhe propozimi i cili u miratua njëzëri që kjo rregullore të shkoj si tërësi për plotësim ndryshim. Arsyeshmëria qëndron në faktin se edhe herën e kaluar kur e kemi propozuar rregulloren anëtarët e KPF-së e dinë që kam qenë e zëshme edhe në atë kohë kur ka qenë drejtor tjetër kush që ta shqyrtojmë secilën pikë me një kujdes të veçantë. Arsyeshmëria e miratimit ka qenë deklarimi i ekzekutivit se kanë biseduar me të gjitha grupet e bizneseve prandaj ne nuk guxojmë që sot ta bëjmë të njëjtin gabim dhe të sjellim një ndryshim të një rregulloreje vetëm për pika të caktuara. Ne duhet të kemi parasysh se mund të ketë biznese dhe kategori të bizneseve të cilat në mënyrë individuale mund të na kenë thënë se kanë pakënaqësi por që ndoshta këto pakënaqësi nuk kanë ardhë deri te zyra e drejtorit për ta paraqit një pakënaqësi të tillë, andaj kjo është më e pakta ne që mund të bëjmë sepse kjo është në interes të përgjithshëm për qytetarët tanë dhe për ne që ta përfundojmë punën si duhet.

Kjo nënkupton që rregulloren ta hedhim në plotësim ndryshim të tërë pastaj pas një muaji te debatit publik t'i marrim rekomandimet, sugjerimet nga përfaqësuesit e punëtorëve, nga punëtorët dhe nga përfaqësuesit e bizneseve dhe kështu do të jetë më e lehtë që ta bëjmë më të mirën të mundshme bashkërisht me ata për të cilët bëhet kjo rregullore. Unë ju ftoj të gjithëve që ta miratojmë rregulloren që të shkoj si tërësi sepse si e tillë u miratua në rendin e ditës dhe pastaj të plotësohet përse të vendosim një diktat dhe të përcaktojmë nene të caktuara kur ne mund ta hedhim të tërën dhe pastaj propozimet më të mira mund të vijnë nga përfaqësuesit e punëtorëve dhe bizneseve.

znj.Lirika Maliqi, theksoi, ne si Grup i këshilltarëve nga radhët e LVV-së jemi kundër kësaj pike të rendit të ditës pasi që kjo pikë nuk është e përgatitur dhe e kompletuar ngase kemi dy lloje të propozimeve dhe nuk e kemi të qartë se çka po dërgojmë në diskutim publik kur kemi një propozim nga drejtori i DPZHE, kurse propozimi tjetër është sjell nga KPF-ja prandaj ne si grup i këshilltarëve nga radhët e LVV-së jemi kundër kësaj pike.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, rregullorja ekzistuese për orarin e bizneseve duhet me u ndryshu, ky Kuvend në mënyra politike ka kaluar rregullore si ka dashur vetë, këtë që po e them është shumë e vërtetë. Ish drejtori i DPZHE së bashku me tre këshilltarët e Kuvendit që kanë kaluar tani në Grupin

e LVV-së herën e kaluar e kanë kaluar rregulloren e mëparshme. Ky Kuvend rregulloren duhet ta kalojë në interes të qytetarëve. Kryetari i Komunës po e thotë që mos të diskutojmë rreth kësaj rregulloreje mirëpo ne nëse nuk diskutojmë atëherë nuk mund t'ia lehtësojmë punën Ekzekutivit sepse ne nuk kemi kurrfarë përgjegjësie si opozitë që jemi, ne nuk i kemi marrë votat e qytetarëve me qeverisë dhe jemi opozitë, ky Kuvend e ka kaluar rregulloren e cila është në fuqi, natyrisht me një shumicë të këshilltarëve ku disa prej tyre kanë qenë në subjektet tjera politike mirëpo tani kanë kaluar në Grupin e këshilltarëve të LVV-së. Kundër asaj rregulloreje ka diskutuar LVV-ja, tani paragrafi 20 i kësaj rregulloreje që e propozoj drejtori i DPZHE thotë se mund të marrë vendim të posaçëm kur e kërkon interesi publik, pyetja ime për drejtorin është, cilat biznese janë me interes publik sipas jush, pra cili biznes është interes publik sipas teje që do t'ju adresohet me kërkesë.

Ne i njohim bizneset e Podujevës, i njohim të gjithë dhe u'a njohim shërbimet që i kryejnë. Atë që e ceku Kryetari i Komunës për ditën e diel që për një shërbim qytetarët duhet të shkojnë në fshatin Lupç, kurse këshilltarja nga radhët e LVV-së znj. Lirika Maliqi deklarohej se nuk e dimë se çfarë po dëshirojmë këtu, ajo mundet mos me ditë se çka po dëshirojmë, mirëpo unë e di se çfarë po kërkoj personalisht si këshilltar.

Këto debate është dashur të përfundojnë në Grup së bashku me drejtorin e DPZHE para se me ardhë në KPF kjo pikë, dhe të bëheshin rekomandime për këto biznese që janë në interes publik për t'ju japë lejen e punës pas orës 13:00 ditëve të diela. Nesër mund të ballafaqohesh me 500 biznese ditën e diele në ora 13:00 e që teknikisht dokumentacionin nuk mund ta përgatitësh, qoftë nëse ai dokumentacion është me pagesë apo pa pagesë.

Problemi është se kjo rregullore e cila është sjellë dhe është miratuar nga LDK-ja, me ish drejtorin e DPZHE z. Mirsat Kamerolli, i cili ka paraparë çështje të tilla në takime me përfaqësuesit e bizneseve, e njëjta duhet të ndryshohet. Duhet të sjellët procesverballi i takimeve me përfaqësuesit e bizneseve dhe të mbahen takime me punëtorët e sektorit privat dhe pasi që të merren mendimet e të gjithëve vendoset për plotësim ndryshim të kësaj rregulloreje. Ne jemi anëtarë të partive politike por nuk mund të jemi në shërbim të grupacioneve politike sepse ne jemi përfaqësues të qytetarëve të Komunës së Podujevës. Ne si Kuvend duhet të dalim me një qëndrim për këtë propozim rregullore, andaj në këtë kontekst e pyes znj. Lirika Maliqi se a është pro që kjo rregullore të vazhdojë sipas propozimit të drejtorit të DPZHE apo të mbetet në fuqi rregullorja e vjetër/aktuale, apo keni ndonjë propozim për të bërë zgjidhje, nëse s'ke propozim ne mund të vijmë në seancë të nënshkruhemi në listë për paga dhe mëditje dhe të ecim për në shtëpi, mirëpo gjendja jetë ashtu siç është.

Nëse secili grup i këshilltarëve nuk guxon të deklarohej publikisht se çfarë po dëshiron si këshilltarë i Kuvendit Komunal atëherë ai është një problem tjetër që duhet të diskutohet, nëse dikush nga këshilltarët dëshiron të votojë herë për përfaqësuesit e subjekteve majtiste, herë për ato djathtiste sipas interesit privat dhe kalon nëpër procese politike, kurse gjendja në Komunën e Podujevës mbetet e njëjtë edhe ky është një problem që duhet të diskutohet.

Unë kërkoj nga ky Kuvend që rregullorja ekzistuese që është në fuqi dhe që zbatohet nga qytetarët e Komunës së Podujevës, të dal në diskutim publik dhe kërkoj nga drejtori i DPZHK që të mbaj takime me përfaqësuesit e bizneseve, si dhe nga ky Kuvend kërkoj ta zgjedh një grup punues qoftë prej Kuvendit qoftë prej Ekzekutivit dhe të mbajë takime me punëtorët dhe përfaqësuesit e bizneseve të sektorit privat si dhe t'i merr propozimet e tyre, pastaj vota ime do të jetë pro. Këtu janë miratuar çështje ashtu siç i ka konvencuar një subjekti politik për 20 vite me radhë duke u shëtitur poshtë e lartë këshilltarët e Kuvendit Komunal. Ne po diskutojmë këtu në Kuvend dhe asnjë veprim nuk po ndërmerret, kurse kur po dalim jashtë këtij Kuvendi në rrugë të gjithë flasin ndryshe.

Pra së bashku me drejtorin e DPZHK t'i vizitojmë bizneset dhe të dëgjojmë propozimet e tyre qoftë në vizita në terren apo në takime në këtë Kuvend me të gjitha bizneset e Komunës së Podujevës si

dhe me punëtorët e sektorit privat, pastaj të tregoj unë se çka thonë ata, sepse këtu në këtë Kuvend ne mund të propozojmë çka të dëshirojmë dhe t'i votojmë ato propozime.

znj.Lirika Maliqi, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e LVV-së i patëm shumë të qarta qysh në fillim të seancës, ne kërkuam që të shtyhet kjo pikë e rendit të ditës.

Kam pyetje për këshilltarin e Kuvendit nga radhët e PDK-së **z.Rafet Llapashtica**, çka po kërkon ti me dërgu në diskutim publik, propozimin për plotësime të rregullores që është sjellë nga drejtori i DPZHE apo plotësim ndryshimin e rregullores në tërësi.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, rregullorja ekzistuese për orarin e bizneseve, në tërësi të ndryshohet sepse ky dokumentacion nuk specifikon asgjë **znj.Lirika Maliqi**, mua po më vjen keq se tani po duhet me diskutu rreth kësaj çështje, zonja Maliqi, drejtori i juaj asnjë ndërhyrje në këtë dokument nuk e ka bërë pas rekomandimit nga mbledhja e KPF-së, e që është pajtuar edhe vet ai, asnjë ndryshim të ndonjë rreshti nuk e ka bërë. Unë nuk kam mundësi që të kyçem në kompjuterin e tij dhe të ndërhyj dhe të shkruaj pasues që i miraton Kuvendi. Në këtë Kuvend dhe në këtë Komunë ekzistojnë inatet politike, këtu një drejtor apo Kryetari i Komunës që është në pushtet, kur nuk kalon ndonjë propozim i tyre, atë propozim e shtyjnë derisa ta blejë dikë, kështu ka ndodhur edhe me qeverisjen e kaluar nga LDK-ja, madje mos me i kalu një propozim ish Kryetarit **z.Agim Veliu** i cili për 20 vite e ka lënë Komunën e Podujevës në këtë gjendje, nëse mendoni se është bërë ndonjë ndryshim atëherë nuk mund ta sjellë një plan pune në këtë mënyrë.

Unë tani nuk mund ta gjykoj **z.Avni Fetahun** i cili për 20 vite s'ka sjellë plan pune në Kuvend, kurse tani që ka kaluar në LVV, kërkon plan pune, nuk ka ndryshuar ai drejtor më shumë se ai që ka qenë sepse identiteti i njeriut nuk ndryshon për tre muaj. Qëndrimi i tij nuk mund të ndryshoj, ju merruni me drejtorin e juaj sepse me mua kurrfarë problemi nuk keni, unë votoj pro kur është dokumentacioni në rregull kurse kur nuk është dokumentacioni në rregull po të jetë Kryetari i Komunës nga radhët e PDK-së unë votoj kundër.

znj.Doruntina Hasani, theksoi, më duket se po keqkuptohet ky debat, të gjitha subjektet politike e kemi votuar këtë rregullore sepse kemi menduar se po i mbrojmë të drejtat e punëtorëve dhe askush nuk ka qenë kundër kësaj rregulloreje. Gjatë këtij viti ne e kemi parë se kemi bërë gabim në miratimin e kësaj rregulloreje dhe të gjithë pajtohemi se nuk ka qenë mirë e menduar kjo rregullore, sidomos për pjesë të caktuara turistike që janë dëmtuar jashtëzakonisht shumë. Ne këtu kemi një amulli sepse shumë qytetarë e kanë ditë se ka me u bë një plotësim ndryshim. Unë i kam njoftuar qytetarët se do të bëhet ky plotësim ndryshim i kësaj rregulloreje kurse tani këtu po del e gjithë rregullorja në plotësim ndryshim që ndoshta do të ketë ndonjë lajthim në këtë rast.

Në seancën e ardhshme është dashur që të presim që të vij kërkesa nga drejtori dhe të dal në diskutim publik. Unë nuk po ju kundërshtoj, mirëpo është dashur që kjo çështje të sqarohet në një seancë tjetër.

z.Hasan Ajeti, theksoi, ne sot si temë e kemi diskutimin e propozim rregullores për orarin e punës së bizneseve, asgjë më shumë. Kjo rregullore kur është miratuar nuk ka qenë kohë e pandemisë ku pas shfaqjes së saj janë shfaqur edhe shumë të panjohura. Sot drejtori i DPZHE e ka parë të arsyeshme që të plotësohet dhe ndryshohet kjo rregullore sepse e njëjta nuk është “Bibël e as Kuran”, që nuk mund të plotësohet dhe ndryshohet. Aspekti procedural është tjetër, mendim i imi ka qenë që ky plotësim ndryshim të shkoj si pako/tërësi sepse shumë biznese qofshin të vogla apo të mesme kanë qenë të përjashtuara nga draftimi i propozim rregullores për plotësim dhe ndryshim që është propozuar tani nga drejtori i DPZHE. Mirëpo tani e kemi propozimin për plotësim ndryshim të rregullores në tërësi, te formati i shkrimit se sa është konciz është zyra juridike, për diskutimin publik të gjitha këto janë të rregulluara me ligj, dhe këtu nuk shohë asnjë drojë te bizneset.

Unë e kam lexuar propozimin që është sjellë nga drejtori i DPZHE e që ka shumë biznese të vogla dhe të mesme që nuk janë përfshirë në plotësim ndryshim dhe tani kjo rregullore ka shkuar në tërësi për diskutim publik. Interesi i përgjithshëm është që t'iu ndihmojmë bizneseve për shkak të të panjohurave dhe pasojave financiare që ka sjellë pandemia Covid-19. Kur i referohemi kësaj rregulloreje, në të kaluarën është rregulluar vetëm orari i punës së bizneseve që operojnë në Komunën e Podujevës. Ju e dini se edhe në kohën kur kemi qeverisur ne, ka qenë një OJQ e cila ka ngritur çështjen për disa biznese që operojnë në fshatin Orllan dhe respektivisht i kemi dhënë mbështetje pa bërë cilësimin ose kualifikim në aspektin politik. Për këtë çështje nuk ka politikë, ju zotëri drejtor i DPZHE jeni i Zoti i shtëpisë dhe ti del dhe ballafaqohesh andaj hartojë dhe konsultohu mirë për këtë çështje pastaj kur të vish në debat, drafti i rregullores të jetë konciz dhe i saktë mbi atë bazë që interesi i përgjithshëm të tejkalon aspektin politik, prandaj e them dhe është mirë që ky draftim i rregullores të shkoj në tërësi.

znj.Fatlume Jaha, theksoi, në rend të ditës sot u miratua që të shkojë plotësim ndryshimi i kësaj rregulloreje me rekomandimet e KPF-së, që u miratua me votim. Rekomandimet e KPF-së që i kemi pranuar dje, është edhe materiali bazë që e ka sjellë drejtori i DPZHE por edhe si pikë e dytë është propozimi që me unanimitet të plotë, madje edhe me propozimin e Kryetarit të Komunës ka shkuar që të jetë plotësim ndryshimi i rregullores në tërësi. Unë dua të them se nuk e di pse ka hezitim përderisa unë konsideroj se edhe drejtori i DPZHE dhe Ekzekutivi në tërësi, absolutisht nuk duhet me pas ndonjë dilemë sepse edhe ju si subjekt politik dilni mirë nëse i përfaqësoni dhe i përfshini të gjitha kategoritë e bizneseve, e jo vetëm kategoritë e caktuara. Nuk ka ndonjë problem për mua personalisht apo për dikë tjetër që në debat publik t'i përmendi pikat që i keni propozuar dhe pastaj të merrni miratimin dhe nëse bizneset dhe përfaqësuesit e punëtorëve janë në një linjë me atë që ju e keni propozuar, ne me kënaqësinë më të madhe e pranojmë, pse jo, por që të ketë gjithë përfshirje në ditën e debatit publik por edhe gjatë periudhës 1 mujore sa do të jetë në diskutim publik kjo rregullore. Propozoj që të provoni të kontaktoni me të gjitha kategoritë e bizneseve dhe të shihet se ku janë bërë gabimet eventuale në të kaluarën, nëse është bërë në mënyrë të gabuar rregullorja e kaluar atëherë ne jemi të gjithë së bashku këtu që të bëjmë më të mirën për bizneset, për punëtorët dhe për të gjithë qytetarët e Komunës së Podujevës, kurse për zonat turistike që u përmenden duhet pasur kujdes se çka parasheh ligji për ato zona.

znj.Mrika Thaçi, theksoi, për këtë rregullore rezervat e mia i kam shfaqur edhe në vitin që e lamë pas kur ishte në rend pune për miratim. Sigurisht ato janë të evidentuar në procesverbalin përkatës kur është miratuar nga kjo përbërje e këtij Kuvendi, ku ndryshim kemi vetëm Ekzekutivin dhe sallën ku jemi. Edhe atëherë por edhe tani mendoj se me këtë rregullore qëllim më s'ka se kemi kontribuar në rregullsitë dhe liritë e operatorëve ekonomik që të zhvillohen dhe të operojnë në frymën e ekonomisë së lirë dhe konkurrencës në tregun e lirë.

Sikurse atëherë dhe tani mendoj se të drejtat dhe liritë e punëtorëve i rregullon ligji i punës, organizatat sindikale, inspektorati i punës dhe e fundit Gjykata. Këtë e them sepse ka dominuar një mendim që me këtë rregullore ju mundësohet një ditë pushimi brenda javës, ndërsa nuk është marrë parasysh ajo që thash më lartë, tregu u i lirë, konkurrenca e lirë, e drejta për shërbim dhe furnizim qytetarëve. Me këtë propozim rregullore dhe ndryshimin e saj do të mundësohej rregullimi në një formë tjetër dhe do të lehtësohej marrja e shërbimeve dhe furnizimeve në të mirë të qytetarëve. Specifikisht vërejtja ime në këtë propozim ndryshim të kësaj rregulloreje që mendoj se duhet përmirësuar, konsiston se është në nenet kur flitet për ditët e pushimit, gjegjësisht zëvendësimit të ditëve të pushimit. Po e citoj pikën e 7, në rast se nata e vitit të ri ose nata e bajramit bie ditën e diel ose në festë zyrtare, bizneset nga paragrafi 1,2,3,4 dhe 5 mund të punojnë sipas orarit të rregullt të përcaktuar për periudhën kohore. Neni 3.4 prapë përsëritet përafërsisht e njëjta gjë vetëm se me emra

tjerë Fitër Bajram, Kurban Bajram, vërejtja ime konsiston në këtë se emërtimi Fitër dhe Kurban po më duket se po rrëshqet nga tradicionalja te ne, këto emërtime i kemi pas si Bajram i madh dhe Bajrami i Vogël, këto dy festa zyrtare janë në kalendarin e festave zyrtare të Republikës së Kosovës dhe të emëruara zyrtarisht, andaj përse duhet të emërohen specifikisht. A mendon dikush se kur numërohen festat zyrtare të cilësuar si festa zyrtare sepse i kemi numëruar specifikisht ditët e festave zyrtare, çka do të bëhet me kërkimet dhe festat tjera zyrtare të komuniteteve tjera.

Kjo e bënë këtë rregullore të kontestueshme nisur nga të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të sanksionuara me ligjet e Kosovës. Kjo rregullore po na bëhet si ura e shenjtë që me vite mos me pas mundësi me arrit një draft final. E mbështes ndryshimin dhe besoj se kontributin tim do ta japë edhe gjatë diskutimit publik.

z.Ragip Fetahu, theksoi, për besë unë s'jam kah e kuptojë këtë debat tash, të gjithë e kemi vullnetin dhe dëshirën për me ndryshuar këtë rregullore në interes të bizneseve, mua së pari më vjen keq prej bizneseve për këtë mënyrë të debatit që po zhvillohet këtu sepse është totalisht i pa nevojshëm ky debat. Drejtori i DPZHE ka gatishmëri që gjithë së bashku të debatojmë dhe t'i ndajmë idetë përkatëse dhe të tregojmë para qytetarëve një seriozitet. Është mirë që drejtori në fjalë ka shpreh gatishmërinë që të takohen gjitha grupet e këshilltarëve të subjekteve politike, pa dallime politike dhe të draftojmë një rregullore në interes të bizneseve dhe të qytetarëve.

z.Haki Rudari, theksoi, dëgjova me vëmendje diskutimet e kolegëve nga subjektet tjera politike ku më shumë e fuqizuan atë që unë e potencova që të gjejmë një konsensus rreth kësaj rregulloreje për arsye se përfaqësuesi nga LDK-ja pati vërejtje në rregulloren aktuale që është nxjerrë nga Ekzekutivi i kaluar, dhe pse prapë ne në të njëjtën formë të ngutemi sot. Përfaqësuesi nga radhët e PDK-së në një farë mënyre ka vërejtje në këtë rregullore por e pyes atë, përse ka aq rëndësi që kjo rregullore sot të shkojë për diskutim publik. Nga diskutimet e deritanishme vërehet se kjo rregullore ka mangësi. Unë mendoj që propozimi ynë që kjo rregullore të shtyhet, tani ky mendim po fuqizohet edhe nga kolegët tjerë nga subjektet tjera politike në këtë Kuvend. Kjo rregullore është për bizneset, për qytetarët e në këto raste është mirë që të gjithë të dalim nga petku partiak dhe ajo çka është në interes të qytetarëve ta përkrahim. Propozimet e drejtorit të DPZHE i dëgjuam dhe ka mundësi që rregullorja të plotësohet dhe ndryshohet dhe t'i marrim mendimet e përfaqësuesve të bizneseve dhe ta shtyjmë këtë propozim rregullore për një seancë tjetër, e jo prapë kjo rregullore të vihet në dëgjim publik me këto mangësi, andaj qëndrimi i Grupit të LVV-së është që të shtyhet kjo rregullore për një seancë të radhës në mënyrë që të merren parasysh edhe faktor të ndryshëm si dhe përfaqësuesit e bizneseve.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, po ju drejtohem dy përfaqësuesve nga radhët e LVV-së z.Haki Rudarit dhe z.Ragip Fetahut, ju po kërkon që të kaloj kjo rregullore ashtu siç është sjellë nga drejtori DPZHE, kërkesa e drejtorit dhe e Grupit të këshilltarëve të LVV-së është që të kalojë kjo rregullore ashtu siç është aradhe propozimi. Ky debat është duke u zhvilluar si rezultat i mos punës së drejtorit të DPZHE, ku këshilltari nga radhët e LVV-së z.Ragip Fetahu deklarohet për propozimet që i ka bërë dhe të jap mendimin e kësaj propozim rregulloreje që nëse kalon si draft dhe askush nuk e jep asnjë propozim qofshin përfaqësuesit e bizneseve apo ata të subjekteve politike, atëherë a mund të konsiderohet kjo si rregullorja më e mirë për Komunën e Podujevës. Unë e kam lexuar shumë mirë rregulloren, por a mund të më shpjegoni ju ose drejtori në fjalë se cili biznes është interes publik që t'i lëshohet leja pastaj ashtu siç e ka paraparë në nenin 8.20, pra cili biznes është interesi publik dhe pse ai biznes është interes publik, kurse tjetri nuk është. Pse një biznes duhet të marrë leje në DPZHE për të punuar kurse tjetri jo, kah lindi kjo ide apo ku e keni gjetë këtë rezolucion ju që një biznes me marrë leje e tjetri jo, prandaj mos të votojmë ne sipas dëshirave personale dhe pastaj me deklarata para mediave nëpër rrugë duke të thirruri në qytetar.

z.Ragip Fetahu, theksoi, i nderuar z.Rafet Llapashtica, të lutem së paku dëgjo se çka po them unë dhe Grupi i këshilltarëve nga radhët e LVV-së, është e vërtetë kjo se është pak si shkak i mos punës së drejtorit të DPZHE dhe ka kritikë shumë të madhe, mirëpo ejani të ulemi së bashku dhe ta trajtojmë këtë çështje në interes të bizneseve dhe ta hartojmë një rregullore ashtu siç është më së miri për bizneset tona Llapjane.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, për të mos e zgjatur debatin më shumë, të del kjo rregullore në debat publik dhe ne pastaj i japim propozimet.

z.Kasib Bashota, theksoi, këtu gjatë debatit u politizua jashtë mase tema në fjalë, andaj unë propozoj që të gjendet një pajtueshmëri mes punëtorëve, qytetarëve dhe bizneseve. Është mirë që të gjendet një mes i artë në mes të punëtorëve, qytetarëve dhe bizneseve. Është mirë që të ulen të gjitha Grupet e këshilltarëve të subjekteve politike dhe t'i eliminojnë të gjitha ato mangësi dhe të futen gjitha ato prioritetet që janë në të mirë të punëtorëve sepse edhe punëtorët i kanë ankesat e tyre dhe pyesin pse Komuna ditën e diel nuk punon. Është mirë që të gjitha Grupet e këshilltarëve politik të arrijnë një konsensus për me shty përpara këtë çështje në të mirë të gjithëve dhe jo të politizohet gjithçka sepse jemi për t'i mbrojt të drejtat e qytetarëve dhe bizneseve dhe të ecin gjërat përpara.

z.Florent Hasani, theksoi, u dukë se nuk ke i qartë qëndrimi i asamblistit të LVV-së, sepse nuk kishte mbështetje për propozimin e drejtorit të DPZHE dhe as për propozimin që e prezantoj kolegja asamblistë që rregullorja në fjalë të shkoj si tërësi në diskutim publik, pra qëndrimi i Grupit të këshilltarëve të LVV-së ishte që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për një seancë tjetër të radhës.

z.Fatmir Gashi, sqarim parafolësit, theksoi, propozimi i drejtorit të DPZHE ishte që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për një seancë tjetër, mirëpo ky propozim nuk kaloi në votim, kështu që tani duhet të vazhdojmë me pikat e rendit të ditës ashtu siç u miratua.

z.Pajtim Balaj, drejtor DPZHE, theksoi, i mora të gjitha shënimet dhe tani po dëshiroj të sqaroj se rregullorja nuk mund të shkoj në votim si tërësi për ndryshim ashtu siç u propozua nga disa këshilltar. Kjo kërkesë është e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe zyrtarisht si e tillë është dorëzuar ashtu dhe nuk janë përfshirë rekomandimet e KPF-së, kjo propozohet si draft.

Gjithçka mund të diskutohet në debat publik, për këtë mund ta konsultojmë edhe zyrën ligjore sepse nuk po flas vetëm ashtu ngase jam konsultua me zyrën ligjore para se me ardhë në këto përfundime. Debatit publik i nënshtrohen vetëm propozimet e nxjerra nga Drejtoria në draftin e rregullores, rregullorja aktuale nuk mund të shqyrtohet në tërësi ashtu siç propozuan disa këshilltar komunal dhe si të tillë e votuat që të hyjë në rend të ditës paraprakisht. Sa unë jam konsultuar me zyrën ligjore rekomandimet nuk janë obligative, ne e kemi përgatitur punën tonë e cila dëshmon për punën tonë. Këtë draft ne nuk e kemi sjellë në Kuvend jo me kërkesën tuaj por me kërkesën tonë që dëshmon se ne kemi pasur zell të punës, mundeni me u pajtuar ose jo me përfundimet që është çështje tjetër për me u diskutuar gjatë periudhave të debatit publik, por fakti që kjo është kështu dëshmon për punën tonë. Lidhur me nenin 20 besoj se është shumë e qartë, DPZHE mundet me vendim të posaçëm kur e kërkon interesi publik të lejoj punën e bizneseve në tërësi e jo vetëm të një biznesi ashtu siç po pretendohet, bizneseve në tërësi edhe në ditë pushimi apo ditë festash.

Takime me biznese ka pas, puna në këtë draft ka filluar pas kërkesave të shumta të grupeve të ndryshme të bizneseve, draftimi nuk përfshin vetëm shitoret ushqimore sepse po më duket se i gjithë diskutimi është drejtuar në të, draftimi përfshinë ordinancat e veterinarisë, barnatoret bujqësore, barnatoret medicinale, berberët dhe fushat të tjera. Sa për rikujtim ky është një draft që mundet me u ndryshu andaj i gjithë debati që u zhvillua është bërë në lidhje me përmbajtjen e këtij drafti. Rekomandimet që i keni për ndryshimet e pikave të caktuara është periudha e debatit publik kur mund t'i jepni e jo këtu sot. Unë e kuptoj nevojën për të bërë politikë sepse ne politikë bëjmë këtu sepse jemi përfaqësues të subjekteve politike dhe nuk ka ndonjë problem për me bërë politikë ngase po

abuzohet shumë me nocioni e politikë bërjes, këtu jemi në një organ politik dhe nuk ka diçka të keqe për me bë politikë, e kuptoj se edhe ju politikë e keni këtë punë dhe nuk më mbetet hatri se duhet ta arsyetoni vendin që e keni zënë para qytetarëve, mirëpo kjo nuk bënë të kaloj në banalitet dhe me kundërshtuar gjithçka sepse LVV ka dëshmuar që në të kaluarën ka qenë konsistente kur ka qenë në pyetje interesi publik.

Sa i përket të drejtave të punëtorëve arsyeja pse kemi draftuar këtë rregullore dhe nuk kemi filluar një procedurë të krijimit të një rregullore të re është se qëllimi i rregullores së vjetër ka qenë i mirë, me gjithë problemet që janë hasur gjatë punës praktike gjatë gjithë vitit besoj se qëllimi ka qenë i mirë. Të gjithë ne këtu kemi obligim ndaj qytetarëve, punëtorëve, bizneseve dhe qëllimi për me ju dhënë atyre pak pushim ka qenë i mirë, përkundër se kjo si kompetencë për çështjen e të drejtave të punëtorëve dhe pushimeve janë kompetencë e Inspektoratit të Punës. Përfundimet janë në harmoni me kërkesat e përfaqësuesve të bizneseve. Po më pëlqen bashkëpunimi i opozitës sepse është një kundërshtim i çuditshëm sepse bashkoheni në kundërshtimin ndaj nesh edhe pse kërkesat i keni diametralisht të kundërta, nuk e di a e keni dëgjuar njëri tjetrin, kërkesat e juaja janë krejt të kundërta ndaj njëra tjetrën por që është bashkimi opozitar kundër LVV-së, apo qëllimi që ju bashkon atëherë jemi në rregull. Nuk përmenda asnjë emër besoj se ky draft duhet të kaloj në votim pa diskutime ngase nuk kam përmendur asnjë emër të këshilltarëve.

znj.Fatlume Jaha, theksoi, faleminderit shumë që erdh kjo ditë me ju dëgju, dhe çka me thënë përveç që ju falënderoj shumë. Drejtorit të DPZHE veç dua ti them që përveç dy Grupeve të këshilltarëve nuk di qysh me ta deklaruar edhe Grupin e këshilltarëve të LVV-së, që e pate kundër propozimit tënd, veç për hir të korrektësisë, për me zbrit prej nivelit të politikës te profesionalizmi atëherë dua ta pyes zyrën ligjore që nëse një konstatim të KPF-së e kemi pranuar ku përfshihet edhe pika që rregullorja të shkoj në tërësi në diskutim publik që është përfshirë dhe votuar për të hyr në rend të ditës, dhe nëse me ato konstatime të KPF-së kalon me shumicë të votave, nuk po e paragjykoj rezultatin, por të supozojmë se kalon çka po nënkupton kjo, po bie në diskrecionin e drejtorit se do ta merr për bazë atë ose jo, dhe nëse mbetet ashtu atëherë ku po mbetet puna e Kuvendit.

z.Florent Hasani, theksoi, ne Grup i këshilltarëve të LVV-së nuk jemi kundër pikës së rendit të ditës por jemi kundër që të kaloj sot ky propozim, pra ky është qëndrimi ynë.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, kur një njeri është i pa përgatitur për detyrën e tij dhe nxjerrë gjëra/mendime tjera dua t'i jap sqarime, dëgjo z.Pajtim Balaj drejtor DPZHE, krejt kjo punë nuk është bashkim opozitar sepse së bashku me ju ne kemi qenë opozitë para 3 muajve, ktheju arkivave të procesverbaleve të mbledhjeve të kaluara dhe shikoj debatet e këshilltarëve. Unë po them se dje në KPF ke insistuar që ta sjellësh në Kuvend këtë pikë të rendit të ditës kurse sot po insiston që e njëjta të hiqet nga rendi i ditës, t'i ke konflikt me kërkesën tënde, në mbledhjen e KPF ke insistuar që ta sjellësh në Kuvend këtë pikë të rendit të ditës dhe i keni rekomandimet nga KPF, mirëpo nuk e përfunduar asnjë punë ti zotëri drejtor i DPZHE sepse asnjë rresht në rregullore nuk e ke ndryshuar siç kemi marrë vendim në KPF. Këtë pikë të rendit të ditës e kemi votuar në mbledhjen e KPF-së andaj ka kaluar sot në Kuvend sepse ju jeni deklaruar se keni mbajtur takime me përfaqësuesit e bizneseve edhe pse sot ju është dashur të jeni shumë praktik dhe ta paraqitni procesverbalin e takimeve. Jam shumë i bindur se ju nuk e dini as numrin e bizneseve që operojnë në territorin e Komunës së Podujevës, më mirë e di unë që s'jam drejtor se sa ti, meqë që po hynë në këto terme bashkim opozitar e të ngjashme, absolutisht nuk personifikon asgjë si LVV, vetëm kur të përmend dikush më bie ndërmend për ty, meqë po dëshiron të hysh në te aspektet politike e jo politike.

Unë po të them se tani sërish po duhet me të nxjerrë prej (lloçi) situatë, jo nuk bëhet fjalë këtu për bashkimi opozitar, por vota e këshilltarit sepse po duhet me ngritë dorën me votu për me shty pikën

e rendit të ditës për të cilën nuk e keni kryer punën kurse mandati të kalon edhe dy muaj sepse derisa të miratohet kjo rregullore ne hyjmë në zgjedhje tjera, prandaj të lutem mos bë shaka. T'i me pas pak përgatitje dhe qëndrim moral duhet me dhënë dorëheqje këtu në foltore, me u deklarua se nuk e keni kryer detyrën dhe në vendin tënd Kryetari e emëron dikën tjetër që e kryen detyrën dhe që mësohet të punoj në institucion dhe e din se çka është KPF-ja, rekomandimi i Kryetarit të Komunës, sepse tani më shumë në aspektin procedural dhe administrativ po del se e kemi mbështet më tepër ne Kryetarin e Komunës se sa ti drejtor që e ke Kryetar ngase dikush e ka votuar këtu brenda Komunës dhe ne e kemi respektuar atë mendim të qytetarëve, andaj e them se vetëm dil në foltore dhe deklarohesh dhe e liron vendin, por jo të deklarosh me terma bashkim opozitar etj çfarë i ceke.

Asgjë ti drejtor nuk ke qenë më shumë se unë kundër qeverisjes së LDK-së, sepse nuk e ke dëgjuar asnjë zë, veç ke marrë subvencione përmes Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit derisa i ke ra kitarës dhe ja ke këputur krejt telat, mos më shti me folë, po po shumë e vërtet është, nuk ka subvencion n'kuadër të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit që se ke marrë për vete, t'i e ke krye shkollën, e po del po tregon qëndrime politike.

I nderuar Kryesues, kaloje si të duash këtë pikë, madje si të dëshiroj drejtori i DPZHE ne po ia japim votat, nëse dëshiron edhe prej rendit të ditës po e heqim ne si PDK po flas, vetë, dil i nderuar Florent Hasani si shef i Grupit të LVV-së, propozojë për votimin propozimin e drejtorit të DPZHE dhe ne do ta votojmë për ta tërheqë nga rendi i ditës, votën time e ka pro, vetëm që ta nxjerrim prej kësaj situate sepse nuk kemi kohë të ndalemi gjithë ditën në këtë pikë.

z.Hasan Ajeti, theksoi, kjo rregullore e rregullon orarin e punës së bizneseve, unë këtu po e shohë që po ceken të drejtat e punëtorëve dhe subjekteve tjera, ato janë ligje tjera që e rregullojnë këtë materie. Ky dokument rregullon vetëm fillimin dhe mbarimin e bizneseve që operojnë në Komunën e Podujevës, asgjë më shumë dhe tani nuk kemi nevojë me hy në materie që rregullohen me Ligjin e punës, atë për siguri dhe shëndet në punë etj. Këto propozime janë sjellë nga drejtori i DPZHE, të njëjtat kanë kaluar në KPF. Unë jam ithtar i asaj që rregullorja në fjalë duhet të kalojë në pako dhe të inkorporohen edhe propozimet tjera dhe si e tillë të harmonizohet edhe nga diskutimet publike, çështje këto të cilat janë elementare dhe që duhet t'i dijë secili prej nesh.

z.Pajtim Balaj, drejtor DPZHE, theksoi, çështjet personale mendoj se nuk duhet me i sjellë në Kuvend, është marrë me mua shumë personalisht këshilltari z.Rafet Llapashtica i cili tani do të ishte mirë të qëndronte në sallë të Kuvendit pas atij deklarimi që e bëri në mënyrë që të dëgjoj edhe tjetrin, mua në këtë rast, se çka po thotë.

Kitarës nuk di me i ra (nuk di të luaj me kitarë) dhe ndihem shumë keq që s'jam mësuar të luaj me kitarë edhe pse e kam pas pasion shumë gjatë. Sa i përket subvencioneve dhe akuzave tjera që u cekën, këshilltari zotëri Llapashtica dje e ceku se ka respekt për babin tim kurse sot e thotë që babai im është "hajn" dhe po e përdor foltoren e Kuvendit që të lëshoj akuza të tilla, çështje për të cilën ju lus të gjithëve, kush do që din dhe çka do që din, nëse mund ta dëshmoj për këto pretendime le të urdhëron, janë organet e drejtësisë, por edhe unë do ta shqyrtoj mundësinë që këto akuza të cilat sigurisht që do të evidentohen edhe në procesverbal, do të marrë hapa ligjor në këtë drejtim.

Çështjet personale nuk sillen këtu, mirëpo meqenëse po sillen edhe unë do të vazhdoj të merrem ligjërisht me to.

Çështja kryesore është që ju po e keqpërdorni gatishmërinë time për me i përfshi propozimet e juaja në draftimin final të rregullores në fjalë, kundërshtimi im për me përfshi këtë rregullore është veç procedural, nuk ka diçka tjetër. Proceduralisht në konsultim me zyrën ligjore e kemi kuptuar që nuk është e mundshme me u përfshi në draft e gjithë rregullorja, diskutimit publik i nënshtrohet vetëm drafti i dorëzuar nga ne. Ne nuk jemi të gjithë juristë dhe nuk i njohim ligjet, për këtë arsye është

nevoja për zyrë ligjore në Komunën e Podujevës, nuk e ka krijuar Shpejtim Bulliqi zyrën ligjore, këtu e kemi gjetë dhe e konsultojmë për gjithçka që është përbrenda kësaj fushe.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, të respektohet këshilltarë të Kuvendit po shohim se janë krijuar dilema mes asaj që është iniciuar nga DPZHE dhe asaj që është iniciuar dhe rekomanduar nga KPF-ja. Askush nuk ka për synim të pengoj plotësim ndryshimin e kësaj rregulloreje. Ne kërkuam kohë që kjo çështje të shtyhet për një seancë të radhës, të ulet Drejtoria përkatëse bashkërisht me përfaqësuesit e subjekteve politike që përfaqësohen në Kuvend, ta analizojnë mirë këtë draftim dhe ta shtyjmë përpara.

Është shumë e vërtetë që me këtë rregullore disa grupe të interesit janë të cenueshme sepse nuk është vetëm një grup interesi, e kemi të qartë se orari i punës së bizneseve është paksa problematik por duhet të kemi të qartë edhe faktin që në këtë orar të punës janë të involvuara edhe subjekte tjera.

Nuk janë vetëm bizneset por janë edhe ata të cilët janë të punësuar në ato biznese, si do që të jetë, në qoftë se mendoni se duhet ta shtyni përpara këtë formë çfarë u deklarua mund ta shtyni sepse është e drejtë e Kuvendit kjo dhe me shumicë e kalon e që pastaj pakica i nënshtrohet shumicës dhe një gjë të tillë e vërejtëm pak më parë se nuk jemi shumicë si subjekt iniciues i këtij plotësim ndryshimi.

Pra po mbetet që gjatë diskutimit publik të punohet shumë me të gjitha grupe të interesit në mënyrë që të nxirret më e mira e mundshme për çka unë absolutisht nuk dyshoj se tek ju nuk ekziston vullneti për një gjë të tillë sepse të gjithë jemi për me nxjerrë më të mirën e mundshme. Do të ishte mirë dhe unë të paktën nga Ekzekutivi do ta bëjë të pamundurën që për këtë çështje të involvohen të gjitha grupet e interesit dhe jo të kemi një rregullore në mënyrë shkel e shko ashtu siç ka ndodhë sepse jam i bindur se po të ishin respektohet të gjitha subjektet politike të cilat kanë qenë të cenueshme drejtpërdrejtë në këtë rregullore, me siguri ne sot nuk do ta kishim një rregullore të tillë. Prandaj aktualisht kemi një rregullore në fuqi për të cilën të gjithë po mendojmë se nuk është e mirë dhe po pretendojmë ta bëjmë një që është më e mirë dhe t'i rregullojmë gjërat në interes të përgjithshëm, kërkuam kohë ne si Ekzekutiv por ju po mendoni se s'ka nevojë të jepet kohë më tepër me u marrë me këtë draft, andaj urdhëroni vendosni ju, shtynë përpara këtë, nuk është problem dhe ne si pakicë në këtë Kuvend vetëm i nënshtrohemi vullnetit të shumicës në këtë rast.

z.Fatmir Rudari, theksoi, deri tani nuk deshta të përfshihem në këtë pikë pasi që kolegu zotëri Rafet Llapashtica ka qenë në mbledhjen e KPF-së, mirëpo jam i interesuar që të dalim nga kjo gjendje, ashtu siç deklaroj edhe zotëri Llapashtica, ne si Grup i këshilltarëve nga radhët e PDK-së do ta përkrahim këtë pikë që të shtyhet për një seancë tjetër, kurse drejtorit zotëri Pajtim Balaj i them që ajo qasja, bashkim opozitar etj që i ceku nuk qëndron sepse ti e ke sjellë në Kuvend këtë pikë dhe ne tani po duhet të vëhemi në një situatë të keqe për të të nxjerrë ty si drejtor i DPZHE prej kësaj gjendje, mirëpo për shkak të qytetarëve ne do ta votojmë dhe jemi për ta heqë këtë pikë nga rendi i ditës.

z.Hasan Ajeti, theksoi, këtu po vërehet se kjo pikë realisht nuk është përgatitur fare nga drejtori i DPZHE edhe pse ky në terma filozofik është i jashtëzakonshëm por këtu nuk është filozofi por është punë profesionale dhe duhet me qenë më serioz edhe në paraqitje. Lidhur me këtë propozim rregulloren dhe për kualifikimet që i bëri më parë rreth çështjeve politike, i them që këtu nuk është punë politike fare kjo ngase kemi të bëjmë me bizneset, prandaj nëse dëshiron ta rregullosh këtë urdhëro je i Zoti i shtëpisë dhe ne duhet ta kuptojmë këtë, e ke marrë votën e qytetarëve dhe tani duhet t'iu dalësh Zot atyre sepse askush nuk po të kualifikon me diçka tjetër sepse ka vendosur sovranin dhe ia pafsh hajrin, por tani i nderuar drejtor i DPZHE mos pretendo me na fut edhe neve në lojë e pastaj të thuash nuk po kam konduksion dhe po e dorëzoj lojën, *(nëse flasim në zhargonin sportiv)*, nuk shkon ashtu bëhu pak më serioz, merri lexoj çështjet, zyrën ligjore e ke pasë atë dhe e ki shefin e kabinetit z.Bajram Ajeti i cili gjoja shumë mirë e njeh këtë materie dhe konsultohu me të

sepse ti vjen nga një fushë tjetër, mirëpo tani të nxirresh kualifikime dhe epitete të ndryshme, jo pushteti i kaluar, jo ai jo ky e të ngjashme, nuk është mirë sepse fundja pushteti i kaluar e ka nxjerrë këtë rregullore, e mirë apo e keqe është kjo që është dhe e cila është nxjerrë në rrethana tjera, para shfaqjes së pandemisë, kurse sot e ke pandeminë, andaj ndihmoju bizneseve që ju ke premtuar, por jo duke mbajtur takime selektive. Nëse dëshiron ta futësh këtë rregullore në plotësim ndryshime, fute në pako si për sallonet e ondulimit, si për berberët dhe për të gjithë por mos i kategorizo bizneset.

Sa i përket draftimit, janë aktet tjera që e rregullojnë këtë materie, të tregojnë zyra ligjore dhe shefi i kabinetit shkëlqesia e tij z.Bajram Ajeti se si hartohen këto sepse ai gjoja ka një bagazh në këtë fushë dhe vjen prej një përvoje 15 vjeçare që ka qenë në qeverisjen e z.Hashim Thaçi dhe ju tregojnë krejt se si bëhen këto. Mos na humbni kohë me këtë çështje sepse kjo është shaka dhe një lojë që po bëhet dhe nuk tregojnë një seriozitet konkretisht për ju si drejtor i DPZHE, ndërsa sa i përket “akuzave” më herët ke akuzuar dhe je lëshuar në nivelin më të ulët të mundshëm, të gjithë e dimë, respekt për “Baben Nexh” dhe familjen e Juaj, asgjë këtu absolutisht nuk e përmendi punën e profesorit z.Nexhmi Balaj, unë ashtu së paku e lexoj. Tani mos na mbaj këtu ligjëratat ti dhe me na shit parim moral, dil burrë deklarohu se nuk jam i zoti në detyrë, sepse ka të tjerë.

znj.Fatlume Jaha, theksoi, nëse rekomandimi i KPF-së hyn si rekomandim në Kuvend dhe kalon në rend dite, votohet a është obligativ të zbatohet nga ana e Drejtorisë apo jo. Ne kemi pasë një rekomandim shumë të qartë i cili është përkrah dhe në KPF dhe i cili u përkrah edhe sot që të hyjë si pikë e rendit të ditës për këtë çështje, përkatësisht që rregullorja në fjalë të votohet si tërësi për diskutim publik. Nuk dëshiroj t'i bëjë presion drejtorit të DPZSHE absolutisht, ai e paraqiti propozimin e tij dhe unë jam shumë e bindur që këtë propozim nuk e bëri pa miratimin edhe të Kryetarit të Komunës sepse është edhe nënshkrimi i Kryetarit aty, prandaj përgjegjësia është kolektive. Ne po mundohemi ta bëjmë më të mirën e mundshme, nëse është mundësia të kaloj sot kjo pikë ashtu siç kemi rekomanduar nga KPF-së, zyra ligjore duhet të na tregoj a është obligative apo jo sepse ne u pajtuam që bashkërisht të bëjmë më të mirën e mundshme për këtë rregullore. Këtë po ua them me sinjoretin më të madh.

z.Pajtim Balaj, drejtor DPZHE, theksoi, u stërgjatë paksa ky debat dhe tani po kalojmë në përsëritje të gjërave të njëjta, por unë po e përsërisë sërish, kërkesa ime për ta shtyrë këtë pikë të rendit të ditës ka ardhë në konsultim me zyrën ligjore për shkak se proceduralisht nuk mund të përfshihet në draftin që është i pjesshëm diskutimi i gjithë rregullores. Nuk ka qëndrim ose tërheqje politike prej punës time, proceduralisht unë vetëm kam dashtë të jem më bashkëpunues e që po më duket se më doli keq kjo gatishmëri. Në konsultim me zyrën ligjore kemi vendosur që kjo pikë të shtyhet për një seancë tjetër që në diskutimet e ardhshme me u përfshi e gjithë rregullorja që ju e keni kërkuar në fillim.

z.Agim Behluli, theksoi, sinjorisht po e them se është për keqardhje kjo lojë që po e bëjmë me biznese, prej atyre njerëzve që marrim taksa çdo ditë sepse i kemi lodhë dhe mërzitë ata njerëz. Ne për këtë gjë kaq të thjeshtë nuk mund të merremi vesh, çka mund të bëjmë nesër me të tjerët, kemi një rregullore për të cilën në kohën kur është miratuar s'më ka pëlqyer fare dhe i kam shpreh vërejtjet e mia edhe në Grup, por edhe në seancë të rregullt. Tani as kjo rregullore s'po më pëlqen, në qoftë se fillojmë ne me marrë mendime të qytetarëve dhe të bizneseve atëherë unë po deklaroj se si punëdhënës që po të ishte e mundur i kisha lënë punëtorët në punë 24 orë, kurse ata punëtorë janë të interesuar me punua vetëm 8 orë në ditë. Të bëhemi të sinjorisht dhe të marrim një vendim të formës së prerë dhe mos të bëjmë shaka me këta njerëz sepse i ka lodhur gjendja e pandemisë dhe ndarja e mjeteve në formë jo të drejtë. Ne këtu për një orë flasim për diçka që mund të rregullohet për 10 minuta. Në këtë propozim rregullore në një dispozitë e kam lexuar se veterinerët mund të punojnë prej orës 7:00-24:00, prandaj të mos bëjmë shaka me këta njerëz, ta marrim seriozisht këtë çështje sepse bizneset duhet me qenë të liberalizuara, bizneset duhet me i pas lëshimet e veta si në të

gjithë botën dhe mos të harrojmë se ne jemi ekonomi e lirë e tregut dhe duhet të gjejmë mënyrën dhe formën se si të ecim tutje. Unë jam shumë i sigurt që punëdhënësit do të vijnë dhe kërkojnë punë deri në infinit kurse punëtorët kanë dëshirë ta kenë një ditë të lirë të punës.

z.Pajtim Balaj, drejtor DPZHE, theksoi, një sqarim të shkurtër në çështjen me orarin e punës së veterinarëve, para se me vendos ne i kemi takuar të gjithë, kanë ardhë në zyrë dhe na i kanë dhënë propozimet e tyre, mandej ne i kemi hedhë në draft.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, konsideroj se diskutimet për këtë pikë përfunduan dhe nuk ka të lajmëruar të tjerë për të marrë fjalën, prandaj unë e vë në votim këtë pikët të rendit të ditës sipas rekomandimeve të KPF-së, përkatësisht që rregullorja për orarin e punës së bizneseve të miratohet për diskutim publik duke përfshirë edhe propozim rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për orarin e bizneseve të proceduar nga DPZHE.

Pas votimit Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me 13 vota për, 12 vota kundër dhe 7 vota të përmbajtura, miratohet vënia në diskutim publik të rregullores për orarin e punës së bizneseve përfshirë edhe propozimet e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, sipas konstatimeve të rekomanduara nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa.

5. Propozim vendimi për ngritjen e komisionit përzgjedhës - për zhvillimin e procedurave për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në institucionet publike edukativo arsimore në Komunën e Podujevës

z.Avni Fetahu, drejtor i Drejtorisë së Arsimit - DKA, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike, ndër të tjera theksoi, para vetës kemi ngritjen e komisionit përzgjedhës për zhvillimin e procedurave për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në institucionet publike edukativo arsimore në Komunën e Podujevës, përbërja e këtij komisioni si propozim është: Blerim Vllasa kryesues i këtij komisioni nga DKA, Nazif Sheqa anëtar i komisionit nga Këshilli i prindërve (të bëhet përmirësim i emrit në konstatime të KPF-së), dhe përfaqësuesit e MASH të cilët janë përcaktuar në bazë të kërkesës që i'u kemi bërë, Fetah Kosumi, anëtar, për nivelin arsimor fillor të mesëm të ulët, Sahit Berisha anëtar, për nivelin arsimor të mesëm të lartë, dhe Imrane Ramadani anëtare për nivelin e arsimit para fillor.

z.Shaban Bajoku, theksoi, ne Grup i këshilltarëve nga radhët e LDK-së pajtohemi se Udhëzimi Administrativ përkatës i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës e përcakton dhe e rregullon procedurën e ngritjes së komisionit intervistues për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve të shkollave, prandaj ne e përkrahim këtë, mirëpo kam një pyetje për drejtorin e DKA-së, rreth përfaqësuesit të prindërve se a ka njohuri dhe kualifikime nga fusha e arsimit sepse është shumë me rëndësi që në komision të jetë person i kualifikuar rreth çështjeve të arsimit.

z.Bahri Blakçori, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e LVV-së e përkrahim këtë propozim.

z.Fatmir Rudari, theksoi, edhe ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e PDK-së e përkrahim këtë propozim.

z.Avni Fetahu, drejtor DKA, theksoi, është e vërtetë se në Udhëzimin Administrativ përcaktohet se në komision mund të jetë një ekspert i jashtëm i cili ka përvojë në arsim, për fat është një konkurrencë e madhe që shumica e kandidatëve veç se kanë aplikuar për drejtor dhe ka qenë e pa mundur me përzgjedhë një ekspert të asaj natyre. Jeni në dijeni që kryetar të këshillit të prindërve nuk ka pas, është bërë një përzgjedhje. Ne kemi pas vetëm një takim, kemi pas kërkesa prej tyre dhe ata kanë qenë të lirë në përzgjedhjen e tyre dhe kemi menduar se kryetari i këshillit të jetë në atë

përbërje. Përndryshe kam njohuri se ky anëtar ka fakultetin e përfunduar dhe është i përgatitur mirë në profesion.

Pas votimit, kryesuesi i Kuvendit konstatoj se njëzëri u miratua propozimi vendimi për ngritjen e komisionit përzgjedhës për zhvillimin e procedurave për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në institucionet publike edukativo arsimore në Komunën e Podujevës, me këtë përbërje:

-Blerim Vllasa, zyrtar për arsimin e mesëm të lartë në Drejtorinë e Arsimit, kryesues,

-Nazif Sheqa, kryetar i Këshillit të prindërve, anëtar,

Nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës (varësisht nivelit të arsimit)

-Fetah Kasumi, anëtar i Komisionit (për nivelin e arsimit fillor dhe të mesëm),

-Sahit Berisha, anëtar i Komisionit (për nivelin e arsimit të mesëm të lartë),

-Imrane Ramadani, anëtare e Komisionit (për nivelin e arsimit parashkollor) dhe,

Nga shkolla përkatëse caktohen dy përfaqësues të Këshillit Drejtues (një prind dhe një mësimdhënës) në cilësinë e vëzhguesve.

6. Informatë për aktivitetet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi – KKSB, për vitin 2020

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kemi të bëjmë me informatë të KKSB-së për vitin 2020, informatë në të cilën sa kam vërejtur janë përfshirë një mori temash dhe aktivitete, andaj urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën.

znj.Doruntina Hasani, theksoi, e kemi lexuar informatën e KKSB-së për vitin 2020, siç e dini ky Këshill është një mekanizëm për mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e sigurisë edhe pse gjithmonë kemi pas informata e jo ndonjë veprim që është bërë. Kjo informatë është e vitit 2020 dhe ne nuk mund t'ju adresohemi zyrtarëve të Ekzekutivit të kaluar, viti që po e lëmë pas ka qenë i goditur nga pandemia e cila po vazhdon edhe në këtë vit. Për vitin e kaluar ka qenë diçka e re pandemia, përveç pandemisë kemi harruar edhe gjërat kryesore me të cilat rrezikohemi çdo ditë, njëra ndër to është siguria në komunikacionin rrugor, e them këtë sepse dëshmitarë të shumë aksidenteve nga mungesa e sinjalistikës nëpër rrugët ku për fat të keq kemi shumë aksidente me fatalitet. Rruga magjistrale është në kompetencë të Ministrisë së Infrastrukturës Rrugore, mirëpo KKSB duhet t'i ketë për bazë këto çështje sepse ky Këshill është për të mbrojtur jetën dhe sigurinë e qytetarëve.

Sa i përket vitit 2020 një çështje që nuk është trajtuar që si rezultat i mbylljes totale të vendit nga pandemia ka pasur rritje të rasteve të dhunës në familje, çështje kjo e cila është diskutuar mjaftë në nivelin qendror por në informatat e KKSB-së asnjëherë kjo çështje nuk është përfshirë.

Sugjeroj që këtë vit të merren veprime nga KKSB e jo vetëm të ketë informata sikurse vitet e kaluara.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, **lidhur me këtë pikë** bëhet fjalë për informatën rreth aktiviteteve të KKSB-së për vitin 2020, nëse ndokush dëshiron fjalën urdhëroni nëse jo kjo është vetëm një informatë dhe nuk kërkohet t'i nënshtrohet procesit të votimit andaj mund të kalojmë në pikën e radhës.

7. Propozim Plani i punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi – KKSB, për vitin 2021

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kemi të bëjmë me propozim Planin e punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi – KKSB për vitin 2021, material të cilin e keni marrë me kohë dhe keni mundur ta analizoni, andaj nëse ndokush dëshiron fjalën urdhëroni nëse keni pyetje, vërejte, sugjerime apo plotësim ndryshime, nëse jo unë e vë në votim.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri u miratua propozim plani i punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi – KKSB për vitin 2021 sipas materialit përkatës dhe konstatimeve të Komitetit për Politikë dhe Financa.

8. Propozim vendimi për ndarjen e mjeteve buxhetore për subvencionimin e transportit të donacionit nga Shoqata “Human Bridge” me seli në Suedi

z.Driton Veliu, drejtor Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale – DSHMS, e paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tjera theksoi, bëhet fjalë për një donacion nga Shoqata “Human Bridge” me seli në Suedi, përfaqësues i kësaj shoqate është z.Xhafer Balaj, kjo shoqatë ka sjellë disa donacione me vlerë 150,000.00€ dhe ne i kemi ofruar bashkëpunim dhe shpresojmë se edhe neve do të na e sjellë një donacion të njëjtë. Donacionin e parë kjo shoqatë e ka dërguar në Komunën e Pejës. Përfaqësuesi i shoqatës ka kërkuar një subvencionim për transportin e këtyre mallrave ku shuma e transportit është rreth 4,500.00€, ne kemi caktuar një shumë në vlerë prej 5,000.00€ që mos t’na bie puna që të merremi prapë me të njëjtën gjë. Në këtë donacion kemi pajisje moderne dhe mjete të ndryshme, shtretër të ri dhe pajisje tjera të cilat nevojiten për njerëzit me nevoja të veçanta, në këtë rast për “Handikos” që ka 860 anëtar.

Kërkoj përkrahjen e juaj për mbështetjen e kësaj iniciative për bashkëpunimin e Komunës së Podujevës me Organizatën “Human Bridge” me seli në Suedi, Organizatë e cila ka sjellë disa donacione në Republikën e Kosovës dhe në Republikën e Shqipërisë konkretisht në Republikën e Shqipërisë e ka sjellë një donacion të njëjtë për spitalin e përgjithshëm të Bashkisë së Shkodrës, kurse në Republikën e Kosovës ka sjellë një donacion në Komunën e Pejës dhe një donacion e ka sjellë për QKUK-në, ku një pjesë e këtij donacioni i është dhënë Komunës së Obiliqit. Unë nuk e di në detaje se çfarë pajisjesh mjekësore janë por ne shpresojmë se shumicën e këtyre pajisjeve mund t’i shfrytëzojmë për QKMF-në dhe AMF-të në Komunën e Podujevës, jo të gjitha pajisjet që sjellën mund të jenë për kujdesin parësor shëndetësor, ato që ne mund t’i përdorim i shfrytëzojmë kurse pajisjet tjera që nevojiten për personat me nevoja të veçanta mund të ju ofrohen atyre organizatave që ofrojnë këto shërbime. Shpresoj se do të hasim në mirëkuptimin e juaj dhe ta përkrahni këtë iniciativë bashkëpunimi.

z.Adnan Zymeri, theksoi, në emër të Grupit të këshilltarëve nga radhët e LDK-së, e përshëndesim dhe e mbështesim iniciativën e DSHMS-së së bashku me organizatë “Human Bridge” me seli në Suedi, si dhe mbështesim çdo iniciativë që në mënyrë direkte apo indirekte e përmirëson sistemin tonë shëndetësor dhe u’a lehtëson jetën personave me nevoja të veçanta duke ditur problemet e tyre të ndryshme që nga infrastruktura dhe probleme tjera.

znj. Adelina Stublla, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e LVV-së e përkrahim çdo donacion që është në të mirë të qytetarëve e sidomos në sektorin e shëndetësisë kur dihen nevojat dhe kërkesat duke filluar nga fluksi i madh i pacientëve që adresohen në QKMF.

Falënderojmë donatorin për këto pajisje mjekësore që do të futen në përdorim dhe nuk do të qëndrojnë në depo siç kanë qëndruar më parë duke i'u humbë vlera dhe duke u vjetërsuar pa hyrë në funksion.

z. Bashkim Sylja, theksoi, edhe ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e PDK-së e përkrahim këtë donacion ashtu siç kemi përkrahur çdo vendim në këto 3 vite të kësaj legjislature kur kanë qenë në pyetje çështje në të mirë të qytetarëve të Komunës së Podujevës.

z. Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, pra kemi të bëjmë me një propozim vendim sipas të cilit subvencionohet transporti i donacionit nga Shoqata "Human Bridge", andaj nëse ndokush dëshiron fjalën urdhëroni nëse jo, unë e vë në votim këtë pikë të rendit të ditës sipas materialit përkatës dhe konstatimeve të rekomanduara nga Komitetit për Politik dhe Financa.

Pas votimit Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri u miratua propozim vendimi për ndarjen e mjeteve buxhetore për subvencionimin e transportit të donacionit nga Shoqata "Human Bridge" me seli në Suedi, sipas materialit përkatës të dërguar dhe konstatimeve të rekomanduara nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa

9. Të Ndryshme

Kryesues i Kuvendit, u'a rikujtoj të gjithë këshilltarëve të Kuvendit se afati për deklarimin e pasurisë është deri më 31 mars 2021, prandaj ju bëjë thirrje të jeni të kujdesshëm dhe të vëmendshëm në këtë aspekt dhe të deklaroni pasurinë në mënyrë që mos të kem probleme pastaj.

z. Florent Hasani, theksoi, kam një kërkesë nga Shoqata e invalidëve të luftës, për asamblenë komunale, ku përfaqësuesit e shoqatës në fjalë kërkojnë që në një shtëpi ku kanë qëndruar ilegalisht për të cilën nuk është përcaktuar lokacioni, të vendoset një pllakë përkujtimore.

Po ashtu edhe një pllakë tjetër të vendoset aty ku është sulmuar stacioni i policisë në Komunën e Podujevës.

z. Pajtim Hodolli, theksoi, po e paraqes një kërkesë të banorëve të fshatit Llapashticë e Epërme dhe fshatit Katunishtë, kërkesë e cila i adresohet Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, duke parë se Komuna vazhdimisht është duke vendosur ndriçimin publik nëpër fshatra dhe duke parë se rruga lidhëse mes këtyre dy fshatrave të cekura kalon nëpër zonë malore, bëjë ftesë që të merret parasysh kjo kërkesë e qytetarëve të atij lokaliteti që të vendoset ndriçimi publik.

z. Adnan Zymeri, theksoi, një çështje që është shumë e ndjeshme për shoqërinë, bizneset dhe komunën tonë është edhe çështja e personave me probleme mendore dhe lypsarëve. Duke marrë parasysh kompetencat e niveleve të qeverisjes e di që mundësitë e komunës në këtë aspekt janë shumë të vogla, andaj kërkoj nga Drejtoria përkatëse që ta bëjë një kërkesë për trajtim institucional të kësaj çështje e cila çdo ditë po bëhet më shqetësuese në aspektin financiar për bizneset sepse në bazë të disa të dhënave informale në Komunën e Podujevës janë rreth 75 persona që kërkojnë lëmoshë, dukuri kjo e cila paraqet problem dhe të gjithë ne e dimë sepse hasim për çdo ditë në ta, prandaj për fillim një kërkesë për trajtim institucional të kësaj çështje do të ishte e duhur.

z. Qendrim Softolli, theksoi, kam një kërkesë për Ekzekutivin e Komunës që t'i lirojë nga tarifa komunale dhe qiratë, bizneset që shfrytëzojnë pronën publike duke parë gjendjen e rënduar si shkak i pandemisë dhe si shkak i ndërtimit të sheshit përgjatë rrugës "Zahir Pajaziti".

Në vitin 2020 bizneset janë liruar nga këto pagesa, andaj kërkoj që kjo kërkesë e imja të merret parasysh që bizneset të lirohen nga tarifa komunale dhe qiratë, përfshirë edhe bizneset të cilat shfrytëzojnë pronën publike, fjala është edhe për vitin 2021 të ketë lirime të tilla.

z.Ragip Fetahu, theksoi, dua ta ngrisë një problematikë, pjesa veriore e qytetit është lënë pas dore nga ana e Ekzekutivit për 20 vite, sidomos në fshatrat më të thella siç janë fshatrat Dobërdol, Kërprimëh dhe Metehi që janë në kufirin e migrimit të popullsisë nga fshati në qytet, pjesë e cila ka nevojë për investime lokale. Duke marrë parasysh këtë fakt propozoj që për pishat e fshatrave Dobërdol, Kërprimëh dhe Metehi, të hartohet një plan konkret nga Drejtoritë përkatëse që të krijohet një park sikurse që është parku verior i qytetit i cili do të mundësonte lehtësimin e jetës së qytetarëve dhe investime private në atë zonë dhe rrjedhimisht do të gjeneroheshin vende të reja të punës për këtë pjesë të qytetit sepse kjo pjesë është prekë jashtëzakonisht shumë prej migrimit të popullsisë nga fshati në qytet.

Pastaj në fshatin Repë që është në kufirin e fshatrave ku popullsia ka lëvizë nga fshati në qytet për shkak të kushteve jo të mira infrastrukturore kemi një infrastrukturë shumë të keqe të rrugëve, kemi Lagjet Sejdu dhe Rrustemi dhe shumë lagje të tjera të cilat jetojnë në lloç. Për ta parandaluar migrimin e popullsisë nga fshati në qytet duhet patjetër pushteti lokal të marr masa dhe të filloj t'i trajtoj këto rrugë, unë me këtë rast ftoj drejtorin e Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe atë të Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit që bashkërisht t'i vizitojmë këto zona sepse vërtetë po zbrazen nga popullsia, thjeshtë nga mungesa e dorës së pushtetit lokal.

z.Agim Behluli, theksoi, kam një pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Administratës, objektin e gjendjes civile në fshatin Herticë kur do e rregulloni sepse ai objekt është i shkatërruar totalisht.

z.Bahri Selimi, drejtor Drejtorisë së Administratës - DA, lidhur me pyetjen e parafolësit theksoi se për pyetjen e parashtruar, përgjigjen do ta merrni me shkrim.

z.Patriot Rudari, theksoi, banorët e fshatit Shajkoc e kanë bërë një ankesë më dt.27.05.2020, ndaj rojës së pyllit Selman Rrahmani së bashku me djemtë e tij i cili ka prerë së paku 48m³ dru në pronë shoqërore dhe disa metra të tjera në pronë private. Komisioni komunal më dt.03.06.2020, në përbërje z.Xhavit Avdiu inspektor, znj.Majlinda Gashi zyrtare e pylltarisë dhe znj.Hamide Selmani zyrtare e pylltarisë si dhe Sadik Blakçori teknik, së bashku me ankuesin kemi dalë në vendin e ngjarjes dhe në bazë të koordinatave vërtetohet se në fshatin Shajkoc janë prerë 173 trungje të drurëve të llojit bung dhe qarr me diametër 8 deri 20 cm, rreth 3.5 m³. Në fshatin Lladoc te vendi i quajtur "Roga", janë prerë 269 trungje me diametër 8 deri 40 cm, ka shkaktuar dëm 44m³ të drurëve të prera.

Më dt.08.07.2020 inspektorët së bashku me rojën e pyllit janë dalë në vendin e ngjarjes dhe roja e pyllit ka deklaruar se nuk e ka ditur që është pronë shoqërore. Ish drejtori i DBPZHR, rojës së pyllit vetëm ia ka ndërruar vendin e punës, kurse komisioni disiplinor e ka shkelë ligjin dhe pas tetë muajve nuk ka marrë asnjë masë disiplinore ndaj rojës së pyllit, prandaj kërkoj nga drejtori i DBPZHR dhe Kryetari i Komunës t'ju kthejë përgjigje në ankesë banorëve të fshatit Shajkoc.

z.Kasib Bashota, theksoi, kam disa kërkesa të banorëve të fshatit Llapashticë si një ndër fshatrat që pas luftës ka qenë më të shkatërruarit, mirëpo fatkeqësisht nga ana e Ekzekutivit janë anashkaluar disa projekte urbanistike ku 65% e banorëve të fshatrave Llapashticë e Epërme dhe Llapashticë e Poshtme nuk kanë ujë të pijes, ndërsa 85% e banorëve të këtyre fshatrave nuk kanë trotuare dhe rrezikohet jeta e qytetarëve.

z.Avni Islami, theksoi, është me rëndësi të përcjellët mesazhi i qytetarëve të disa lagjeve jo vetëm në fshatin tim por edhe në fshatrat e tjerë, fjala është për emërtimet e rrugëve që nuk janë emërtuar sipas propozimeve të njerëzve dhe ka ankesa se këto emërtime të rrugëve duhet të ndryshohen, si

dhe të formohet një komision i posaçëm dhe të bëhet riemërtimi i rrugëve, qoftë në lagje të ndryshme apo në rrugët kryesore.

z.Hasan Ajeti, theksoi, kam një pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Administratës, a ka staf të pranuar me kontratë mbi vepër dhe në qoftë se ka besoj se këtë radhë do të na japësh përgjigjen se kush janë ata. E them këtë sepse kur e keni përgatitur raportin për “Alo Komuna” kam pyetur se kush janë ata njerëz dhe mu keni përgjigjur se nuk e di se kush janë, por punojnë ata.

A është respektuar marrëveshja me Ministrinë e Punës për një numër të stafit të punëtorëve me kontratë mbi vepër,

z.Bahri Selimi, drejtor i DA-së, përgjigje parafolësit theksoi, faleminderit për pyetjet i nderuari këshilltar, mirëpo për të gjitha pyetjet e parashtruara, përgjigjet do t’i merrni në formë të shkruar.

Meqë nuk pati të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën, Kryesuesi i Kuvendit e konstatoi të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në ora 12;20

Procesverbalin e mbajti

Enis Sheholli

Nr.01-060/04-0022441/21

Podujevë,

10 mars 2021

Kryesuesi i Kuvendit

Fatmir Gashi